

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI JURIDIK
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË NË PRAKTIKËN GJYQËSORE
TË GJYKATËS THEMELORE GOSTIVAR (2014-2018)**

KANDIDATI:

Meirem Miftari Jao

MENTORI:

Doc. Dr. Vedije Ratkoceri

Tetovë, 2020

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës së magjistraturës së paraqitur është punë origjinale e shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar e tëra ose pjesë të veçanta të saj. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota.

Me respekt

Meirem Miftari Jao

Prindërve të mi dhe shokut tim të jetës...

FALEMNDERIM

Realizimi me sukses i një hulumtimi të mirëfilltë shkencor ishte qëllimi im primar i rrugëtimit tim gjatë këtyre viteve. Për këtë fillimisht jam falenderuese Zotit që më dha shëndetin, motivin dhe vullnetin për të arritur këtë qëllim.

Për realizimin e këtij punimi gjithashtu gjej rastin të falenderoj të gjithë stafin akademik të Fakultetit Juridik në UEJL, të cilët gjatë gjithë këtyre viteve kanë kontribuar në ngritjen dhe formimin tim profesional. Këtu veçanërisht falenderoj për zemërsisht mentoren time Doc.Dr. Vedije Ratkoceri, e cila më është gjetur pranë në çdo moment gjatë kohës që unë kam realizuar këtë hulumtim, duke më dhënë çfarëdo lloj ndihme dhe këshille që unë kam pasur nevojë pa kursyer asgjë.

Falemnderim të posaçëm shpreh për familjen, prindërit e mi dhe bashkëshortin tim, të cilët me përkrahjen e tyre të pakursyer morale dhe financiare bënë të mundur realizimin me sukses të kësaj sfide. Prandaj, dëshiroj që këtë punim t'ua kushtoj atyre sepse pa ndihmën dhe mbështetjen e tyre nuk do të ishte i lehtë realizimi i këtij hulumtimi.

Meirem M. Jao

Qershor, 2020, Gostivar.

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| ABSTRAKT | 1 |
| АБСТРАКТ | 2 |
| HYRJE | 3 |
| QËLLIMI I HULUMTIMIT..... | 4 |
| HIPOTEZAT | 5 |
| METODOLOGJIA E PUNIMIT | 6 |
| KAPITULLI I | |
| MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJIT – ASPEKTE TË PËRGJITHSHME | 7 |
| 1. VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME MBI MARRËVESHJEN PËR PRANIMIN E FAJIT | 7 |
| 1.1 Format specifike të marrëveshjes për pranimin e fajësisë..... | 8 |
| 2. HISTORIK I SHKURTËR MBI PREJARDHJEN E MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJIT | 9 |
| 2.1 Marrëveshja për pranimit e fajit si institut i procedurës penale anglosanksone | 10 |
| 3. PËRPARËSITË DHE MANGËSITË E ZBATIMIT TË MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJIT NË PROCEDURË PENALE | 11 |
| KAPITULLI II | |
| MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJIT NË PROCEDURËN PENALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT | 14 |

| | |
|--|----|
| 1. MARRËVESHJA PËR PRANIMIT E FAJIT SI RISI NË LIGJIN E PROCEDURËS PENALE | 14 |
| 1.1 Aspekt krahasues në mes të Ligjit të vjetër të procedurës penale dhe Ligjit të procedurës penale në fuqi | 16 |
| 1.2 Karakteristikat kryesore të procedurës për marrëveshjen për pranimin e fajit | 17 |
| 2. PROPOZIMMARRËVESHJA | 20 |
| 2.1 Lënda e propozimmarrëveshjes | 20 |
| 2.2 Subjektet procedurale | 21 |
| 2.2.1 Roli i prokurorit publik | 21 |
| 2.2.2 Roli i të dyshuarit | 21 |
| 2.2.3 Roli i mbrojtësit | 22 |
| 2.2.4 Mospjesëmarrja e gjykatësit në procedurën për arritjen e marrëveshjes për pranim të fajit..... | 24 |
| 2.3 Përmbajtja e propozimmarrëveshjes | 25 |
| 3. VEPRIMET QË NDËRMERREN PAS PARASHTRIMIT TË PROPOZIMMARRËVESHJES | 26 |
| 3.1 Vlerësimi i propozimmarrëveshjes | 26 |
| 3.1.1 Seanca për vlerësimin e propozimmarrëveshjes..... | 27 |
| 3.2 Refuzimi i propozimmarrëveshjes | 29 |
| 3.3 Pranimi i propozimmarrëveshjes | 31 |
| 4. SJELLJA E AKTGJYKIMIT NË BAZË TË MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJËSISË | 32 |

KAPITULLI III

ASPEKT KRAHASIMOR I MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJIT, ME THEKS TË VEÇANTË NË KOSOVË DHE SHQIPËRI.....33

| | | |
|---------|---|----|
| 1. | MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS | 33 |
| 1.1 | Nocioni dhe objekti | 33 |
| 1.2 | Marrëveshja për pranimin e fajësisë në aspektin e të Drejtës së Procedurës Penale | 35 |
| 1.3 | Përmabjtja dhe negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë | 36 |
| 1.4 | Vendimet e gjykatës | 39 |
| 1.4.1.1 | Aktgjykimi P.nr.1175/2019 (Gjykata themelore Prizren) | 42 |
| 1.4.1.2 | Aktgjykimi PKR.nr.56/2017 (Gjykata themelore Gjakovë)..... | 46 |
| 1.4.1.3 | Aktgjykimi PKR.nr.164/2019 (Gjykata themelore Gjilan)..... | 51 |
| 1.5 | Ngjashmëritë dhe dallimet me RMV-në | 56 |
| 2. | GJYKIMI ME MARRËVESHJE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË..... | 57 |
| 2.1 | Përmbajtja e marrëveshjes | 58 |
| 2.2 | Shqyrtimi i marrëveshjes nga ana e gjykatës..... | 62 |
| 2.2.1 | Pranimi i marrëveshjes..... | 63 |
| 2.2.2 | Refuzimi i marrëveshjes | 63 |
| 2.3 | Ngjashmëritë dhe dallimet me RMV-në | 64 |

KAPITULLI IV

| | |
|--|-----------|
| STUDIMI EMPIRIK - PASQYRA E TË DHËNAVE STATISTIKORE | 65 |
| 1. SHEMAJ DHE ANALIZË E AKTGJYKIMEVE TË SJELLA NË BAZË TË MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJËSISË NË GJYKATËN THEMELORE NË GOSTIVAR | 65 |
| 1.1 Aktgjykimi K-PP-50/18 | 65 |
| 1.2 Aktgjykimi KPP.бpoj 62/19..... | 68 |
| 1.3 Aktgjykimi K-PP-8/19 | 71 |
| 2. PASQYRË STATISTIKORE PËR TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE GOSTIVAR DHE TË DHËNA STATISTIKORE PËR PUNËN E PROKURORIVE PUBLIKE NË RMV LIDHUR ME MARRËVESHJET PËR PRANIMIN E FAJËSISË | 74 |
| 3. ZBATIMI NË PRAKTIKË I MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJËSISË | 77 |
| PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME | 79 |
| LITERATURA E SHFRYTËZUAR | 81 |

ABSTRAKT

Në këtë tezë të magistraturës të titulluar: **Marrëveshja për pranimin e fajësisë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Themelore Gostivar (2014-2018)**, do të hulumtohet për institutin e marrëveshjes për pranimin e fajit, i cili është inkorporuar si risi në procedurën penale të RMV-së me ndryshimet e Ligjit të procedurës penale të vitit 2010. Do të analizohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me marrëveshjen për pranimin e fajit, duke u nisur fillimisht nga një historik i prejardhjes së këtij instituti dhe përparësive dhe mangësive që ai ka, krahasimi në mes Ligjit të mëparshëm të procedurës penale dhe Ligjit të procedurës penale i cili është në fuqi. Në këtë kontekst do të theksohet rëndësia e futjes së këtij instituti në LPP të v.2010, ndikimi i tij në praktikën e gjykatave në territorin e RMV-së, në punën e Prokurorisë Publike Gostivar dhe zbatimin në praktikë të marrëveshjes. Për të kaluar më pas në analizën e marrëveshjes për pranimin e fajit si institut në procedurën penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë këtu të gjitha çështjet që kanë të bëjnë më të, që nga karakteristikat kryesore të këtij instituti, subjektet dhe roli i tyre, rrjedha e procedurës e deri tek përfundimi i saj me sjelljen e aktgjykimit në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Gjithashtu në kapitullin e tretë të këtij punimi kemi bërë edhe krahasimin e legjislacioneve të vendeve fqinje si Kosova dhe Shqipëria me legjislacionin tonë për sa i përket marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duke u ndalur fillimisht në karakteristikat e përgjithshme të këtij instituti në secilin legjislacion, për të arritur në fund të identifikojmë ngjashmëritë dhe dallimet në mes tyre. Zbatimin në praktikë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në RMV, pasqyrë statistikore dhe analizë të së njejtës së bashku me analizën e shembujve të aktgjykimeve të sjellë më bazë të marrëveshjes për pranimin e fajit në Gjykatën Themelore në Gostivar, i kam vendosur në kapitullin e fundit, por jo të fundit për nga rëndësia duke konsideruar që kjo është pjesa ku unë e kam pasqyruar të gjithë punën time dhe rezultat e arritura nga ky hulumtim.

Fjalë kyçe: *marrëveshja për pranimin e fajit, karakteristikat, subjektet procedurale, iniciativa, propozimmarrëveshja, aktgjykimi në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajit.*

АБСТРАКТ

Во оваа магистерска теза со наслов “Спогодбата за признавање на вина во судската пракса на основниот суд Гостивар (2014-2018)” ќе биде истражуван овој институт, кој е внесен како иновација во кривичната постапка на Република Северна Македонија со измените на Законот за кривичната постапка на 2010 година. Ќе бидат анализирани сите прашања поврзани со спогодбата за признавање на вина, започнувајќи со историјата на овој институт и неговите предности и недостатоци, споредбата помеѓу претходниот ЗКП и новиот ЗКП. Во овој контекст ќе се истакне важноста за воведување на овој институт во ЗКП од 2010 година, неговото влијание врз праксата на судовите во територијата на РСМ, врз работата на Јавното Обвинителство во Гостивар и практичното спроведување на договорот, потоа да се анализира спогодбата како нов институт во кривичната постапка, вклучувајќи и сите други прашања поврзани со овој институт, како неговите облици, субјекти и нивната улога, текот на постапката за спогодување до завршување на постапката со донесување на пресудата врз основа на спогодба за признавање на вина помеѓу јавниот обвинител и осомничениот.

Во третиот дел имам направена компаративна анализа на законодавството на соседните земји, како што се Косово и Албанија со нашето законодавство во врска со спогодбата, фокусирајќи се првично на општите карактеристики на овој институт во секое законодавство, и после конечно успеав да ги идентификувам сличностите и разликите меѓу нив. Во овој дел исто така имам ставени примери на судски пресуди од Косово и Албанија. Спроведувањето на пракса на спогодбата во РСМ, статистички податоци и анализа на истите, заедно со анализата на пресудите донесени врз основа на спогодба во Основниот Суд Гостивар ги поставив во последниот дел на овој магистерски труд, каде јас рефлектирав целата моја работа и резултатите од ова истражување.

Клучни зборови: *спогодба, облици на спогодба, процедурални субјекти, инициатива, предлогспогодба, пресуда врз основа на спогодба*

HYRJE

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Ligji i procedurës penale, për herë të parë në legjislacionin penal e parasheh mundësinë për marrëveshje në mes të prokurorit publik dhe të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij. Kështu, neni me të cilin parashihet ky institut i ri në LPP është neni 483 i cili thotë: “Deri në parashtrimin e akuzës prokurori publik dhe i dyshuari mund të parashtrajnë propozimmarrëveshje me të cilën kërkojnë nga gjykatësi i procedurës paraprake, që të zbatojë sanksion penal e të përcaktuar sipas llojit dhe lartësisë, në korniza të përcaktuara ligjore për veprën konkrete penale, por jo nën kufijtë për zbutjen e dënimit të përcaktuara me Kodin Penal.” parashihet ky institut i ri. Në bazë të këtij instituti mundësohet zgjidhja më e shpejtë e rasteve penale në procedurën penale. Lëndë e marrëveshjes është lloji dhe lartësia e sanksionit penal që do të propozohet në propozimmarrëveshjen, e nëse ekziston pajtim nga i dyshuari lëndë e marrëveshjes mund të jetë edhe kërkesa pronësore juridike nga i dëmtuari.

Përsa i përket çështjes se për cilat vepra penale mund të zbatohet marrëveshja për pranimin e fajit, nuk ka ndonjë kufizim të caktuar dhe ligjdhënësi në këtë pjesë është treguar “zemërgjerë”, duke lejuar kështu zbatimin e kësaj marrëveshje për të gjitha llojet e veprave penale. Por, pavarësisht kësaj kusht themelor për të zbatuar këtë marrëveshje është vullneti dhe dëshira e të dyshuarit për të lidhur marrëveshje dhe pranimi i tij se e ka kryer veprën penale. Iniciativa për zbatimin e kësaj marrëveshje mund të rrjedh nga prokurori, i dyshuari ose nga mbrojtësi i tij, por ashtu siç do të shohim edhe nga ky punim, mungon iniciativa dhe dëshira për zgjidhjen e çështjeve penale me anë të këtij instituti, i cili mundëson edhe zgjidhje më të shpejtë edhe ekonomizim të procedurës penale në të gjitha rastet ku zbatohet, e posaçërisht në rastet kur faktet dhe provat janë më se të qarta se personi i dyshuar e ka kryer veprën për të cilën dyshohet.

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Sistemi i drejtësisë penale është një fushë tejet e rëndësishme së bashkë me procedurat penale, zgjidhja efikase dhe në kohë të arsyeshme e të cilave mundëson arritjen e qëllimit preventiv dhe represiv ndaj kriminalitetit.

Në RMV me Ligjin për procedurë penale të vitit 2010, për herë të parë në legjislacionin penal vendas, ligjdhënësi e parasheh mundësinë e marrëveshjes për pranimin e fajit në mes të prokurorit publik dhe të dyshuarit, prandaj vlerësoj se është më se i nevojshëm hulumtimi dhe studimi shkencor i pavarur i këtij instituti të ri në legjislacion tonë penal.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë, si risi në procedurën penale, për një gjykim të posaçëm i cili është edhe një ekonomi gjyqsore pasi shmang gjykimin në themel të çështjes penale ku nga njëra anë i pandehuri pranon fajësinë në lidhje me veprën penale që i atribuohet si dhe së bashku me prokurorin bien dakort edhe për masën e dënimit duke shmangur institutin e prezumimit të pafajësisë si dhe marrjen e provave të panevojshme si me dëshmitar apo shkresore, fatkeqësisht nuk ka gjetur zbatim sa duhet në procedurat penale në RMV.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi me titull: **“Marrëveshja për pranimin e fajësisë në praktikën gjyqësore të gjykatës themelore Gostivar (2014-2018)”** është arritja e njohurive dhe të dhënave se sa në realitet zbatohet ky institut, cilat janë rezultatet e arritura në zgjidhjen e çështjeve penale me anë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, sa kanë njohuri personat e dyshuar në lidhje me marrëveshjen, si dhe në çfarë mënyre realizohet dhe cilat janë benefitet e zbatimit të së njejtës në praktikë. E gjithë kjo për shkak se kemi mungesë të hulumtimeve në lidhje me këtë institut.

HIPOTEZAT

Kriminaliteti në shoqërinë tonë çdo ditë e më tepër është në rritje dhe bashkë me këtë edhe numri i procedurave penale nëpër gjykata është në rritje e sipër. Çështjet penale duhet të zgjidhen në një afat të arsyeshëm kohor nga ana e gjykatës, por është e njohur se të njëjtat zgjasin më shumë se sa duhet, e që ka ndikim negativ. Zgjidhja që ligdhënësi e ka paraparë dhe e ka futur në legjislacion për efikasitet dhe ekonomizim të procedurave penale për mendimin tim është pikërisht e duhura, prandaj si hipotezë kryesore të këtij punimi shkencor do të kemi si vijon:

- Marrëveshja për pranimin e fajësisë në mes të prokurorit publik dhe të dyshuarit është instituti i procedurës penale i cili ndihmon në zgjidhjen më të shpejtë dhe efikase të çështjeve penale.

Për të qenë e kuptuar hipoteza kryesore do të kemi nevojë për hipoteza ndihmëse siç janë:

- Marrëveshja për pranimin e fajësisë lidhet në mes prokurorit publik kompetent dhe personit të dyshuar, në prani të mbrojtësit të tij, ku lëndë e marrëveshjes është lloji dhe lartësia e sanksionit penal që do të propozohet në propozimmarrëveshjen.
- Propozimmarrëveshja mund ti parashtrohet gjyqtarit të procedurës paraprake deri në ngritjen e akuzës.
- Marrëveshja për pranimin e fajësisë zbatohet shumë pak në praktikë, si pasojë e mungesës së iniciativës nga ana e prokurorisë dhe avokatëve, dhe mosdijes së personave të dyshuar.
- Me aktgjykim në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në praktikë gjykohen personat që kanë kryer vepër penale të rrezikshmërisë së vogël.

METODOLOGJIA E PUNIMIT

Për hulumtimin, kërkimin dhe studimin e rasteve lidhur me këtë punim do të shfrytëzohen këto metoda:

- **Metoda normative** është përdorur për të analizuar dispozitat ligjore të legjislacionit të RMV-së të cilat parashohin Marrëveshjen për pranimin e fajit.
- **Metoda krahasuese** do të zbatohet me qëllim që të bëjmë krahasimin e legjislacionit tonë penal me legjislacionin penal të shteteve fqinje, siç është Kosova dhe Shqipëria, dhe krahasimin e të dhënave në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje në Gjykatën Themelore Gostivar, në periudhën prej vitit 2014 deri 2018.
- **Metoda statistikore** do të përdoret për grupim dhe manipulim me të dhënat statistikore të cilat do të fitohen gjatë këtij hulumtimi në lidhje me rastet e zgjidhura penale në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.
- **Metoda historike** është përdorur për të hulumtuar historikun dhe prejardhjen e marrëveshjes për pranimin e fajit.
- **Metoda e intervistës** është një nga metodat e përdorura në këtë punim. Intervista do të realizohet me gjyqtarë, prokuror dhe avokat nga RMV, të cilët merren në praktikë me lidhjen e këtyre marrëveshjeve dhe sjelljen e aktgjykimeve në bazë të saj.

KAPITULLI I

MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJIT – ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

1. VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME MBI MARRËVESHJEN PËR PRANIMIN E FAJIT

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë përfaqëson një institucion të rëndësishëm nëpërmjet të cilit mundësohet që i akuzuari ta pranojë fajin dhe në këmbim të kësaj të përfitojë lehtësira të caktuara që lidhen me dënimet, përkatësisht sanksionet penale.¹

Marrëveshja për pranimin e fajësisë (*plea bargaining*) është institut i procedurës penale akuzatore anglosaksone, nëpërmjet të cilit gjykatat amerikane zgjidhin shumicën e çështjeve penale. Bazë e këtij instituti është pranimi i fajit nga i pandehuri - *guilty plea* dhe si rezultat i pranimit, i pandehuri mund të heqë dorë nga gjykimi nëpërmjet shqyrtimit gjyqësor dhe të pajtohet me prokurorin për llojin dhe lartësinë e dënimit për veprë ose vepra penale të përfshira në akuzë. Marrëveshjet për pranimin e fajësisë në procedurën penale amerikane nuk kufizohen me peshën e veprave penale, që nënkupton se kjo formë e zgjidhjes së çështjeve penale vjen në shprehje si për vepra të lehta ashtu edhe për vepra të rënda penale, kurse në të drejtën kontinentale marrëveshjet për pranimin e fajësisë vijnë në shprehje dhe zbatohen për vepra të lehta penale ose mesatarisht të rënda.²

Ligji i procedurës penale i RMV-së për herë të parë në vitin 2010 në legjislacionin vendas penalo-procedural e parasheh mundësinë e marrëveshjes në mes të prokurorit publik dhe të pandehurit. Marrëveshja mbi pranimin e fajit është institut procedural i cili ka traditë juridike

¹ Shkodra Vjosa, Zekaj Yll, Doracak për procedurën penale: për avokatët, Shkup, Dhomës Amerikane të avokatisë, 2019. f.70

² Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2018, f. 304,305

shumëvjeçare në shtetet e të drejtës anglosaksone (SHBA dhe Britani e Madhe), në disa shtete evropiane (Italia), si dhe në një pjesë të shteteve të ish Jugosllavisë (Bosnja dhe Hercegovina).³

Edhe përkundër faktit se marrëveshja për pranim të fajit ka rrënjë te e drejta anglosaksone, duhet theksuar fakti se ekziston dallim i madh në mes të motivit për negociata për fajësinë në shtetet me të drejtë zakonore (common law) dhe shtetet evropiane. Modeli anglosakson i marrëveshjes për pranim të fajit është i orientuar kah vëllimi i akuzës – numri, përshkrimi dhe kualifikimi juridik i veprës penale (charge bargaining), ndërsa legjislacioni evropian e pranon konceptin ku temë e bisedimeve dhe e negociatave është lloji dhe lartësia e sanksionit (sentence bargaining).⁴

1.1 Format specifike të marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Është evidente ekzistenca e disa formave të marrëveshjes për pranim të fajit, të cilat nuk përjashtojnë njëra-tjetrën dhe mund të kombinohen:⁵

- **charge bargaining** – marrëveshje për përmbajtjen e aktit të prokurorit sa i përket përshkrimit dhe kualifikimit juridik të veprave penale;

- **fact bargaining** – pajtueshmëri për prezantim selektiv të fakteve, nëse i akuzuari jep deklaratë për pranim të fajit; dhe

- **Forma të veçanta të marrëveshjes:**

- **nolo contendere pleas** – sanksioni pranohet pa dhënie të deklaratës për pranim të fajit në mënyrë të qartë; ka disa përparësi për të akuzuarin, e në fakt i shmanget krijimit të obligimeve

³ Проф. д-р Лазетик Бужаровска Гордана, проф. Калајџиев Гордан, доцент д-р Илиќ Димовски Дивна, Казнено процесно право, Скопје 2015, f.286

⁴ Бужаровска Гордана, Спогудување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карнавалас, Дејвид Ре) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.14,15

⁵ Ibid, f.15,16

për kompensim të dëmit e cila do të mund të ndërlidhej në procedurë civile, që do të pasonte pas përfundimit të procedurës penale në të cilën i akuzuari është deklaruar si fajtor.

▪ ***alford pleas*** – paraqet rastin kur i akuzuari nuk e pranon fajin, por deklarohet se prokuroria ka dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Pranimi i Alfordit, nënkupton pranimin e fajësisë nga personi i cili njëkohësisht thekson shprehimisht se është i pafajshëm. Në të vërtetë, me këtë formë të pranimit, i pandehur heq dorë nga e drejta në gjykim para jurisë duke pranuar që ti shqiptohet dënimi ndonëse njëkohësisht mohon kryerjen e veprës penale e cila i ngarkohet.⁶

▪ ***sentence bargaining*** – pranimi i fajit çon në drejtim të zvogëlimit apo zbutjes së dënimit, gjegjësisht në drejtim të përcaktimit të dënimit me kohëzgjatje më të shkurtër sesa që supozohet se do ta caktojë gjyqi, në rast se do të organizohej procedurë e rregullt gjyqësore.

2. HISTORIK I SHKURTËR MBI PREJARDHJEN E MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJIT

Marrëveshja për pranimin e fajësisë fillet e saja i ka pasur shumë me herët, ndërsa, legjitimitetin e ka arritur në vitin 1970 në rastin Brady vs. United States. Ky rast ka ndikuar që Gjykata Supreme e SHBA-ve të pranojë që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë të jetë pjesë përbërëse e sistemit procedural penal të SHBA-ve. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë në fillim të shekullit XIX ka qenë më shumë si marrëveshje mbi aktakuzën me të cilën paditësi ka pasë mundësi që të tërhiqet nga disa pika të akuzës ose të zbusë akuzën në këmbim të pranimit të fajit për veprën e kryer. Ndërsa, në fund të shekullit XIX marrëveshja ka pësuar ndryshime, ku gjyqtari ka pranuar marrëveshjen e pastaj ka kaluar me marrëveshjen mbi sanksionin. Marrëveshjet për pranimin e fajësisë kanë qenë kryesisht të dominuara me rastet e shitjes së kundërligjshme të

⁶ Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2018, f.305

alkoolit e më pasë janë zbatuar në rastet e veprave më të rënda siç janë vrasjet.⁷ Zgjidhja e rasteve penale në SHBA përmes Marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka influencuar edhe procedurat penale të shteteve të Evropës kontinentale, në të cilat më shumë zbatohet parimi i legalitetit të ndjekjes, kështu që edhe ato kanë filluar të marrin parasyshë zgjidhjen e çështjeve përmes procedurave alternative të pranimit të fajësisë. Nga fundi i shekullit XX, marrëveshja për pranimin e fajësisë ka gjetur aplikimin në vendet Anglo-saksone dhe Euro-kontinentale.⁸

Ekzistojnë disa teori të cilat shtjellojnë idenë nëse procesi i negociimit të fajësisë është i drejtë dhe i barabartë. Përkrahësit e këtij instituti argumentojnë se numri i akuzave është shumë i madh dhe se prokurorëve u mungon koha për të ndjekur të gjitha akuzat përmes seancave gjyqësore, kështu që përdorimi i këtij instituti e përshpejton procesin e gjyqimit. Poashtu, shteti arrinë të përfitojë ekonomikisht në rastet kur marrëveshja e drejtë arrihet pa procese të stërzgjatura. Ndërsa, kundërshtuesit e këtij institucioni, argumentojnë se të pandehurit duhet të trajtohen në mënyrë të paanshme si dhe shkelësit e dhunshëm do të kishin më pak mundësi të merrnin dënime më të buta. Sot, marrëveshja e fajësisë është një pjesë thelbësore e sistemit të drejtësisë penale. Pjesa më e madhe e akuzave, mbi 90 për qind në shumë juridiksione, zgjidhen nëpërmjet një lloji të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

2.1 Marrëveshja për pranimit e fajit si institut i procedurës penale anglosaksone

Plea bargaining është institut i procedurës penale akuzatore anglosaksone, para së gjithash asaj amerikane (*adversarial criminal procedure*), nëpërmjet të cilit gjykatat amerikane zgjidhin mbi 90% të çështjeve penale, por edhe përkundër kësaj ky institut është objekt i debateve pro dhe kundër zgjidhjes së çështjeve penale me aktgjykim në bazë të marrëveshjes

⁷ Fisher George, *Plea Bargaining's Triumph: A History of Plea Bargaining in America*, 2004

⁸ Practical Application of Plea Bargaining for the type and severity of criminal sanction in the 1st year of its application on the neë laë on criminal procedures, OSCE, 2016

për pranimin e fajësisë.⁹ Në procedurën penale amerikane marrëveshjet për pranimin e fajësisë nuk kufizohen me peshën e veprave penale çka do të thotë se këto forma të zgjidhjes së çështjeve penale vijnë në shprehje si për vepra të lehta ashtu edhe për vepra të rënda penale (një numër më i madh i marrëveshjeve i referohet pikërisht veprave të rënda penale).¹⁰

3. PËRPARËSITË DHE MANGËSITË E ZBATIMIT TË MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJIT NË PROCEDURË PENALE

Marrëveshja për pranimin e fajësisë, ashtu si edhe çdo institut tjetër proceduralo-penal i cili futet apo inkorporohet si risi në procedurën penale, duke u bazuar në zgjedhjet apo institutet procedurale penale të shteteve tjera, duke u marrë si i tillë dhe duke u futur në legjislacionin vendas ka ndikuar që të ketë shumë mendime pro dhe kundër marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, benefiteve që ajo sjell dhe poashtu ka mendime që ajo shkel apo cenon disa të drejta themelore në procedurë, siç është për shembull prezumimi i pafajësisë, e drejta për gjykim para gjykatës etj. Prandaj e kam parë të arsyeshme që edhe kësaj çështje ti kushtoj një pjesë të punimit, duke i paraqitur kështu përparësitë dhe mangësitë e zbatimit të marrëveshjeve për pranimin e fajit në zgjidhjen e çështjeve penale.

E drejta konsensuale (me marrëveshje për pranim të fajit) duhet të kuptohet si ridefinim i së drejtës penale dhe pranim i formave të reja të veprimit si përgjigje për veprat më të lehta penale, si mënyrë që të përmbushet ndjenja e pasigurisë dhe të mbahet llogari për interesat e viktimës, me ç'rast kjo praktikë nuk i dëmton garancitë kushtetuese të të akuzuarit. E drejta me marrëveshje për pranim të fajit nxit iniciativë të palëve dhe gatishmëri të tyre për ta pranuar propozimin e palës tjetër, të negociohet, të gjendet zgjidhje kompromisi. Ajo paraqet model, që lë hapësirë për pajtueshmëri të palëve në konflikt, e dhënë me fjalë (të shprehurit e pajtimit) apo me heshtje (mungesë e refuzimit). Insistimi që procedura penale të jetë efikase dhe ekonomike

⁹ Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2018, f.304

¹⁰ Ibid

ka çuar në studimin dhe analizimin e arsyeshmërisë ekonomike dhe të përparësive që e karakterizojnë marrëveshjen për pranim të fajit, e cila konsiderohet si mekanizëm i tregut për përmirësim të kualitetit të ndjekjes penale në ç'mënyrë zvogëlohen harxhimet gjatë procedurës penale.¹¹

Rekomandimi nr. R (87) 18 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për thjeshtësim të të drejtës penale, i cili e rekomandon në mënyrë të prerë procedurën për marrëveshje për pranim të fajit, me qëllim të përshpejtimin të procedurës – kur i akuzuari e pranon fajin nuk duhet të mbahet gjatë në pasiguri për sanksionin që do të pasojë, ka rol të rëndësishëm në zbatimin e të njejtave. Kur i akuzuari e pranon fajin, rregullat e procedurës patjetër duhet të thjeshtësohen. Përshpejtimi ka të bëjë me mosprezantimin e dëshmive që ndërlidhen me gjendjen faktike, me ç'rast procedura është e thjeshtë, e shpejtë dhe efikase, pasi që gjyqi duhet vetëm ta shqiptojë dënimin.¹²

Marrëveshja dhe pranimi i fajit çojnë drejt ridefinimit të plotë të rolit të subjekteve të procedurës, para së gjithash, të palëve dhe të mbrojtësit. Për herë të parë mundësohet dispozita e vullnetit të palëve dhe të mbrojtësit, gjegjësisht gatishmëria e të akuzuarit për ta pranuar fajin, të jetë kusht për shmangie nga procedura klasike penale, në ç'rast racionalizimi dhe përshpejtimi i dukshëm i saj, dhe e gjithë kjo të mundësojnë përmbushjen e së drejtës penale.¹³

Në SHBA zbatimi i marrëveshjeve për pranimin e fajit është aparati kryesor përmes të cilit gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbrojtës bashkëpunojnë dhe punojnë së bashku për qëllimet e tyre individuale dhe kolektive. Përfitimi kryesor i marrëveshjeve për pranim të fajësisë si për prokurorinë ashtu edhe për mbrojtjen është se nuk ekziston rreziku i humbjes së plotë në gjykim.

¹¹Бужаровска Гордана, Спогудување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карналас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.12

¹²Калајџиев Гордан, Лажетик Гордана, Неделкова Лидија ... и др - КОМЕНТАР на Законот за кривична постапка - Скопје, ОБСЕ, 2018. f.964

¹³ Бужаровска Гордана, Спогудување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карналас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.12

Në rastet kur provat për ose kundër një të pandehuri janë në dyshim, marrëveshjet mund të paraqesin një mënyrë të mundshme që avokatët të minimizojnë humbjet e tyre të mundshme duke vendosur një rezultat apo zgjidhje të pranueshme reciprokisht. Prokurorët përfitojnë nga pazaret e pranimi të kërkesave, sepse marrëveshjet u lejojnë atyre të përmirësojnë nivelet e tyre të dënimit. Disa prokurorë përdorin gjithashtu pazare për pranimin e fajësisë, si një mënyrë për të inkurajuar të pandehurit të dëshmojnë kundër bashkëkryerësve ose kriminelëve të tjerë të akuzuar. Marrëveshjet mundësojnë që prokurorët të shmangin gjykimet, të cilat janë humbje kohe dhe të kushtueshme, por nuk garantojnë sukses. Megjithatë prokurorët nuk mund të negociojnë çdo çështje (sepse kjo do të shkaktoje shqetësim publik), ata mund të heqin dorë nga çështjet rutinë ose ato të karakterizuara nga prova të dobëta ose vështirësi të tjera, duke kursyer kohën dhe burimet e tyre për raste që kërkojnë më shumë vëmendje.¹⁴

Me qëllim që të fitohen njohuri të qarta për qëndrimet kundër që kanë të bëjnë me marrëveshjen vlen të përmendim se kundërshtarët e marrëveshjes për pranimin e fajit këtë institut e konsiderojnë si katastrofë në procedurën penale dhe institut që mundëson zbutje të pamërituar të dënimit të të akuzuarit. Sipas tyre, ajo ka mungesa kushtetuese-juridike pasiqë i nënçmon garancitë procedurale të të akuzuarit dhe është në kundërshtim me të drejtat e tij: t'i marrë në pyetje dëshmitarët, të gëzojë mbrojtje në bazë të supozimit se është i pafajshëm, të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik. Përveç kritikave se sanksioni i shqiptuar që ndërlidhet me deklaratën për pranim të fajit, nuk mbështetet mbi bazat penologjike për dënim, vërejtje serioze ka sa i përket rrezikut për personin e pafajshëm që ta pranojë fajin, rrezikun që të propozohet dënim më i madh se sa ai që do ta shqiptonte gjyqi për rastin e njëjtë pas kryerjes së procedurës penale, si dhe "padukshmërinë" e rasteve ku ka deklaratë për fajësi dhe marrëveshje për pranim të fajit.¹⁵ Përveç këtyre, si kritika që i'u bëhen marrëveshjeve për pranimin e fajit janë: marrëveshjet për pranimin e fajit lejojnë paraqitjen e të dyshuarit me një presion të

¹⁴ F. Meyer Jon'a, Plea bargaining, Encyclopædia Britannica, - Encyclopædia Britannica, inc., October 17, 2019 – retrieved from <https://www.britannica.com/topic/plea-bargaining> (accessed February 26, 2020)

¹⁵ Бужаровска Гордана, Спогудување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карналас, Дејвид Пе) - Скопје: OBSE, 2010 f.14

paarsyeshëm, si pasojë e marrëveshjeve mund të vijë deri te një përgaditje e dobët e çështjeve dhe hetimeve, mund të jenë të njëanshme, mund të dënohen njerëz të pafajshëm, është jokushtetues (pasi heq të drejtën për gjykim, që është e drejtë kushtetuese) etj.¹⁶

KAPITULLI II

MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJIT NË PROCEDURËN PENALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

1.MARRËVESHJA PËR PRANIMIT E FAJIT SI RISI NË LIGJIN E PROCEDURËS PENALE

Marrëveshja për pranimin e fajësisë si institut proceduralo-penal është përfshirë në legjislacionin penal të RMV-së, si pasojë e nevojës për zgjidhje sa më të shpejtë dhe efikase të çështjeve penale, si dhe nevojës për ekonomizim të procedurave penale.

Nevoja për zgjidhjen e çështjeve penale përmes mënyrave të ndryshme alternative, si trend bashkëkohor, ka sjellë që edhe LPP i vitit 2010 i RMV-së të aprovojë institutin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.¹⁷ Ligji për procedurë penale¹⁸ përmban dispozita që për herë të parë në vitin 2010 në legjislacionin penal-procedural maqedonas e rregullojnë mundësinë për marrëveshje në mes të prokurorit publik dhe të dyshuarit për llojin dhe lartësinë e sanksionimit penal. Ato parashohin status tjetër të deklaratës për pranim të fajit në fazën e kontrollit të akuzës dhe të pranimit të krimit të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor të procedurës së rregullt, si dhe gjatë shqyrtimit në procedurën e shkurtuar, për dallim nga ajo që e kemi pasur

¹⁶ Marrë nga: <https://connectusfund.org/15-serious-advantages-and-disadvantages-of-plea-bargaining> (accessed February 26, 2020)

¹⁷ Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2018, f.307

¹⁸ Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.150/2010

deri tani sa i përket pranimit të krimit që i akuzuari mund ta jepte para gjyqit. Zgjidhjet e reja me të cilat në mënyrë thelbësore reformohet veprimi procedural, në bazën e tyre paraqesin institute anglosaksone të cilat kanë traditë shumëvjeçare në shtetet me të drejtë zakonore (common law), me përshtatjet e tyre të nevojshme dhe me praktikën legislative evropiane. E drejta tradicionale penale-procedurale dhe praktika gjyqësore që ishin karakteristike për tokën evropiane, e kundërshtonte të drejtën për marrëveshje për pranim të fajit, gjegjësisht të drejtën konsensuale, duke u bazuar në parimin se reagimi ndëshkues është përcaktuar në mënyrë të prerë me ligj dhe nuk njih dialog, kompromis, as marrëveshje, duke pasur parasysh faktin se qëllimi kryesor është mbrojtja e vlerave fundamentale sociale.¹⁹ Një ndër arsyt kryesore të pranimit të marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ishte përpjekja për shkurtimin e procedurës penale në rastet kur gjendja faktike është e pakundërshtueshme për të dyja palët, kur prokuroria disponon mjaftueshëm fakte lidhur me rastin juridiko-penal, prandaj në këtë rast edhe pa shqyrtimin e provave dhe fakteve, gjykatësi mund të sjellë aktgjykim të bazuar, të ligjshëm dhe të drejtë.²⁰

Kështu, në bazë të nenit 483 paragrafi 1 i LPP-së (2010) , *“Deri në parashtrimin e akuzës prokurori publik dhe i dyshuari mund të parashtrojnë propozimmarrëveshje me të cilën kërkojnë nga gjykatësi i procedurës paraprake, që të zbatojë sanksion penal e të përcaktuar sipas llojit dhe lartësisë, në korniza të përcaktuara ligjore për veprën konkrete penale, por jo nën kufijtë për zbutjen e dënimit të përcaktuara me Kodin Penal”*.²¹ Gjithashtu, sipas nenit 335, p.1 propozimmarrëveshja mund të parashtrohet edhe në fazën e vlerësimit të aktakuzës te gjyqtari për vlerësim të së njëjtës. Sipas kësaj kuptojmë se procedura për marrëveshje fillon që nga momenti kur njëra nga palët procedurale e shpreh vullnetin e saj për të lidhur marrëveshje. Propozimmarrëveshja mund të parashtrohet për çdo vepër penale, pra marrëveshje për pranimin e fajit mund të lidhet në rastet kur palët pajtohen me të gjitha rrethanat apo çështjet relevante

¹⁹ Бужаровска Гордана, Спогодување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карнакас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.11

²⁰ Калајџиев Гордан, Лажетик Гордана, Неделкова Лидија ... и др - КОМЕНТАР на Законот за кривична постапка - Скопје, ОБСЕ, 2018. f. 964

²¹Neni 483, p.1 Ligji për Procedurë Penale, 2010

që e karakterizojnë dhe përcaktojnë kryerjen e veprës penale, palët nuk kanë mosmarrëveshje për të njëjtat dhe ato nuk janë lëndë e bisedimeve dhe marrëveshjeve. Në rast se mes palëve nuk ekziston pajtimi lidhur me rrethanat në të cilat është kryer vepra penale apo për disa karakteristika të veprës penale, nuk ka mundësi për fillimin e procedurës për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.²²

1.1 Aspekt krahasues në mes të Ligjit të vjetër të procedurës penale dhe Ligjit të procedurës penale në fuqi

Në këtë pjesë do të shtjellohet shkurtimisht dallimi në mes dy ligjeve të procedurës penale, me fjalë të tjera do të bëhet krahasimi në mes Ligjit të vjetër të procedurës penale²³ dhe Ligjit të ri²⁴ për sa i përket marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Së pari duhet theksuar se Ligji i procedurës penale i vitit 1997, me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet nuk e ka paraparë institutin e marrëveshjes në mes prokurorit publik dhe personit të dyshuar për pranimin e fajësisë dhe sjelljen e aktgjykimit në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajit, por ka paraparë marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim gjyqësor (neni 458). Kështu është paraparë që për vepra penale për të cilat gjykon gjykatësi individual, për të cilat ekzistojnë prova të mjaftueshme, prokurori publik ka mundësi që me propozim akuzë ti propozojë gjykatës të sjellë aktgjykim pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në të cilën mund të propozojë poashtu edhe një apo më tepër sanksione apo masa të tjera, si për shembull dënim me para, ndalim për drejtimin e automjetit, dënim me kusht për dënimin e caktuar deri në tre muaj burgim , konfiskimin e pasurisë, dobisë pasurore etj.²⁵

²² Калајџијев Гордан, Лажетик Гордана, Неделкова Лидија ... и др - КОМЕНТАР на Законот за кривична постапка - Скопје, ОБСЕ, 2018, f.966

²³ “Ligji i vjetër i procedurës penale” i referohet Ligjit për procedurë penale të vitit 1997

²⁴ “Ligji i ri” i referohet Ligjit të procedurës penale në fuqi të vitit 2010

²⁵ Ligji i procedurës penale, 1997

Gjyqtari ka të drejtë ta pranojë apo ta hedhë kërkesën për sjelljen e aktgjykimit pa shqyrtim gjyqësor. Kështu, kur është fjala për vepër penale për të cilën kërkesa e tillë nuk mund të bëhet, gjyqtari e hedh poshtë kërkesën me aktvendim, kurse kur pajtohet me kërkesën, sjell aktgjykim me të cilin shqipton sanksionin ose masat e propozuara nga prokurori publik. Në aktgjykim shënohen të dhënat personale të të pandehurit dhe fakti se pranohet kërkesa e prokurorit publik dhe se shqiptohet dënimi nga kërkesa ndaj të pandehurit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të paraqesin kundërshtim ndaj këtij aktgjykimi.²⁶

Për dallim nga LPP i vitit 1997, Ligji për procedurë penale i vitit 2010 përmban dispozita që për herë të parë në legjislacionin penal-procedural maqedonas e rregullojnë mundësinë për marrëveshje në mes të prokurorit publik dhe të dyshuarit për llojin dhe lartësinë e sanksionimit penal, parashohin status tjetër të deklaratës për pranimit të fajit në fazën e kontrollit të akuzës dhe të pranimit të krimit të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor të procedurës së rregullt, si dhe gjatë shqyrtimit në procedurën e shkurtuar, për dallim nga ajo që e kemi pasur deri tani sa i përket pranimit të krimit që i akuzuari mund ta jepte para gjyqit.²⁷

1.2 Karakteristikat kryesore të procedurës për marrëveshjen për pranimin e fajit

Në Ligjin për procedurë penale të vitit 2010 me të cilin është paraparë marrëveshja për pranimin e fajësisë, janë të paraparë dhe të përcaktuar në mënyrë të detajuar edhe parakushtet themelore që duhet të ekzistojnë apo të plotësohen në mënyrë që të mund të fillohet procedura për arritjen e marrëveshjes. Procedura për sjellje të aktgjykimit në bazë të marrëveshjes për pranimit të fajit në mes të prokurorit publik dhe të dyshuarit i ka këto karakteristika themelore:²⁸

²⁶ Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Tetovë, 2007 – f. 297

²⁷ Бужаровска Гордана, Спогудување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карнакас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.11

²⁸ Ibid f.16, 17

- **Vepra penale** – për sa i përket veprave penale për të cilat mund të sillet aktgjykim në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk ekziston ndonjë kufizim i caktuar që ka të bëjë me pëshën e veprës penale, që d.m.th se marrëveshja lejohet për të gjitha veprat penale, pa marrë parasysh sanksionin e paraparë.
- **Zbutja e dënimit** – gjatë përcaktimit të sanksionimit penal, gjykatësi kompetent është i obliguar që atë ta përcaktojë sipas llojit dhe lartësisë, brenda kornizave të përcaktuara ligjore për veprën konkrete penale, mirëpo jo nën kufijtë për zbutje të dënimit të përcaktuara me Kodin penal;
- **Pëlqimi nga të dyja palët** – propozim-marrëveshja për pranim të fajit është shprehje e pëlqimit paraprak të të dyja palëve dhe nuk lejohet që me këtë marrëveshje të ngarkohet vetëm njëra palë. Gjatë kësaj, aspak nuk është me rëndësi nga cila palë ka ardhur iniciativa për fillim të procedurës për marrëveshje, por është e rëndësishme që te të dyja palët (palët dhe mbrojtësi) të ekzistojë një gatishmëri për t'u kyçur në procedurën e marrëveshjes për pranim të fajit.
- **Kur mund të bëhet marrëveshja për pranim të fajit** – LPP nuk përcakton kufizime sa i përket stadi të procedurës se kur lejohet të bëhet marrëveshja për pranim të fajit, prandaj marrëveshja lejohet në çdo moment mbasi që prokurori publik të sjellë urdhër për fillim të procedurës hetimore e deri kur kryhet vlerësimi i aktakuzës.
- **Modeli i marrëveshjes për pranim të fajit** – ligjvënësi në vendin tonë ka pranuar model të marrëveshjes për sanksionimin penal (sentence bargaining), e jo për veprat penale që do të përfshihen në akuzë. Në fakt, në propozim-marrëveshjen për pranim të fajit mund të përfshihen të gjitha veprat penale apo një pjesë e tyre, për të cilat është sjellë urdhri për procedurë hetimore, mirëpo për veprat që përmenden në urdhër për të cilat nuk është arritur marrëveshje, procedura patjetër duhet të vazhdojë.
- **A është pranimi i krimit parakusht për marrëveshje** – deklarata për pranim të fajit nuk është parakusht për fillim të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit gjatë procedurës hetimore, gjë që nuk ndodh me marrëveshjen për pranim të fajit në fazën

e vlerësimit të aktakuzës, kur pranimi i fajit është parakusht për fillim të procedurës së marrëveshjes për pranim të fajit.

- **Mbrojtja e të dëmtuarit**– me qëllim që të mbrohen interesat e të dëmtuarit, është paraparë një obligim për prokurorin publik që ka të bëjë me propozim-marrëveshjen për pranim të fajit, që së bashku me të gjitha dëshmitë e siguruar, detyrimisht të bashkangjesë edhe deklaratë me shkrim të nënshkruar nga i dëmtuari sa i përket llojit dhe lartësisë së kërkesës pronësore-juridike. Gjatë marrëveshjes është e mundur që të arrihet pajtueshmëri për një pjesë të kërkesës së të dëmtuarit apo ajo aspak të mos jetë çështje diskutimi gjatë procedurës për marrëveshje për pranim të fajit, me ç’rast i dëmtuari nuk mbetet pa mbrojtje edhe në rast kur kërkesa e tij pronësore-juridike aspak nuk ka qenë çështje diskutimi apo është pranuar pjesërisht, ai mund të thirret në aktgjykimin e sjellë për shkak të propozim-marrëveshjes së pranuar, si bazë për t’i realizuar të drejtat e tij në kontest civil.
- **Subjekti i marrëveshjes për pranim të fajit** – lloji dhe lartësia e sanksionit që parashihet në propozim-marrëveshjen për pranim të fajit, në mënyrë të paevitueshme është subjekt i marrëveshjes. Në propozim-marrëveshjen për pranim të fajit duhet të theksohet në mënyrë të saktë sanksioni që propozohet, i përcaktuar për nga lloji dhe lartësia, në kuadër të kornizave të përcaktuara me ligj për veprën konkrete penale, mirëpo jo nën kufijtë për zbutje të dënimit të përcaktuara me Kodin penal.
- **Prezenca e detyrueshme e mbrojtësit** – që nga momenti i fillimit të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit, i dyshuari patjetër duhet të ketë mbrojtës të cilin do ta zgjedhë vet apo do t’i përcaktohet sipas detyrës zyrtare. Në këtë mënyrë zgjerohen mundësitë për mbrojtje të detyrueshme gjatë procedurës penale, që ka për qëllim të sigurojë barazi të armëve dhe të pamundësojë që i dyshuari, i cili zakonisht është laik i legjislacionit, të participojë në procedurën e marrëveshjes për pranim të fajit, pa pasur mundësi për mbrojtje dhe vlerësim të një procedure të këtillë si tërësi, që nga fillimi e deri te rezultati përfundimtar.
- **Ndalesa për pjesëmarrje të gjyqit në marrëveshjen për pranim të fajit**– mos pjesëmarrja e gjyqit në procedurën e marrëveshjes për pranim të fajit është

përcaktuar në mënyrë të prerë, që ka për qëllim t'ia pamundësojë gjyqit që në çfarëdo mënyre të ndikojë mbi palët dhe mbrojtësin, sa i përket vendimit se a t'ia fillojnë procedurës së marrëveshjes për pranimit të fajit, si dhe sa i përket zgjedhjes së llojit dhe lartësisë së sanksionit penal.

2. PROPOZIMMARRËVESHJA

2.1 Lënda e propozimmarrëveshjes

Propozimmarrëveshja, sipas nenit 484 të LPP-së është marrëveshje e shkruar, të cilën e lidhin prokurori dhe i dyshuari me mbrojtësin e tij/saj, me të cilën marrëveshje prokurori publik nga njëra anë dhe personi i dyshuar dhe mbrojtësi i tij nga ana tjetër, vendosin së bashku dhe i propozojnë gjykatës llojin dhe lartësinë e sanksionit penal apo nëse pajtohet i dyshuari propozimmarrëveshja mund të përmbajë edhe kërkesën pronësore juridike nga i dëmtuari, të cilat njëherit paraqesin edhe lëndën e marrëveshjes.

Gjatë bisedimeve për arritjen e marrëveshjes, palët mund të merren vesh edhe për shqiptimin e sanksionit nën minimumin e paraparë ligjor, duke iu referuar normave ligjore për zbutjen e dënimit, për shembull, shqiptimi i dënimit me gjobë në vend të dënimit me burgim, apo shqiptimin e dënimit me kusht në vend të dënimit me gjobë dhe dënimit me burgim. Sanksionet juridiko-penale, palët duhet ti përcaktojnë në mënyrë precize, për shembull, dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muajve, apo dënim me gjobë në vlerë të caktuar në denarë.²⁹

²⁹ Зврлевски Марко, Витларов Тодор, Илиевски Јован - Практична примена на спогодувањето за видот и висината на кривичната санкција во првата година од примената на новиот закон за кривична постапка, Правна анализа, Скопје, 2016, f. 9

2.2 Subjektet procedurale

2.2.1 Roli i prokurorit publik

Nga prokurori publik pritet veprim aktiv në kuptim të inicimit të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit dhe angazhimit për të arritur deri te një sanksion penal që është i pranueshëm nga të dyja palët për veprën apo për veprat për të cilat ai ka sjellë urdhër për fillim të procedurës hetimore. Prokurori publik duhet që fillimisht ta vlerësojë vlerën e dëshmive të mbledhura me të cilat disponon në rastin konkret dhe në bazë të tyre të sjellë vendim se vallë duhet të iniciojë marrëveshje për pranim të fajit, apo do të shfrytëzojë ndonjë mundësi tjetër procedurale që ia ofron LPP-ja, si për shembull, shtyrje të kushtëzuar të ndjekjes penale apo do të zhvillohet procedura e rregullt penale. Në kuadër të autorizimeve të prokurorit publik sipas LPP-së, në mes tjerash, është paraparë edhe detyrimi që ai të negociojë dhe të merret vesh me të akuzuarin për pranim të fajit, në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me LPP. Në drejtim të përcaktimit të rolit të prokurorit publik mund të kontribuojnë edhe aktgjykimet e Gjyqit Suprem të SHBA-ve, ku ekziston një zbatim praktik i suksesshëm shumëvjeçar i marrëveshjes për pranim të fajit. Nga aktgjykimet mund të përfundohet se si obligimet kryesore të prokurorit gjatë procedurës së marrëveshjes për pranim të fajit veçohen:

- ndalesa e dëshirës për hakmarrje;
- roli i garantit dhe i rojtarit të ligjshmërisë; dhe
- vendosja e diskrecionit të plotë e prokurorit sa i përket llojit të veprave penale për të cilat do të bëhet ndjekja apo marrëveshja për pranim të fajit³⁰

2.2.2 Roli i të dyshuarit

I akuzuari është njëra nga palët që merr pjesë në procedurën e marrëveshjes për pranim të fajit, e i njëjti mund të paraqitet në rolin e iniciatorit për fillim të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit. Sipas LPP-së, i akuzuari ka të drejtë që ta paraqesë lirshëm mbrojtjen e tij, të

³⁰ Бужаровска Гордана, Спогодување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карналас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.23

mos jetë i detyruar të japë deklaratë kundër vetes, të afërmeve të tij apo ta pranojë fajin, si dhe të ketë mundësi të deklarohet për faktet dhe dëshmitë të cilat e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe dëshmitë që janë në favor të tij.

Nga i akuzuari pritet që të jetë i njoftuar mirë me karakteristikat dhe mundësitë që i ofron marrëveshja për pranimit të fajit, por edhe me implikacionet që dalin nga kjo procedurë, siç janë:

- heqja dorë nga e drejta për ankesë;
- mundësia për të hequr dorë nga marrëveshja e parashtruar për pranimit të fajit deri sa të silllet një vendim nga ana e gjyqit.
- pasojat të cilat do të ndodhnin, nëse në seancën për vlerësimin e propozim-marrëveshjes për pranimit të fajit bën kërkesë për përcaktim të sanksionit të ndryshëm nga ai që është paraparë në propozim-marrëveshje;
- mundësia që të japë pëlqim që kërkesa pronësore-juridike të jetë subjekt i marrëveshjes për pranimit të fajit; dhe
- pasojat që kanë të bëjnë me kompensimin e një pjese të shpenzimeve të procedurës.³¹

2.2.3 Roli i mbrojtësit

Sipas Ligjit të procedurës penale, që nga momenti i fillimit të procedurës për arritjen e marrëveshjes për pranimitin e fajësisë, i dyshuari patjetër të ketë mbrojtës, të cilin do ta zgjedhë vetë, në të kundërtën mbrojtësin do t'ia caktojë kryetari i gjykatës kompetente.³²

Shprehimisht nuk është e përcaktuar se kur fillon procedura për arritjen e marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, e cila në vete përmban fazën e inicimit të procedurës,

³¹ Бужаровска Гордана, Спогодување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карнавац, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.23

³² Ligji i Procedurës Penale, neni 486

(kur ndonjëra nga palët e merr iniciativën) dhe fazën e bisedimeve dhe arritjen e marrëveshjes. Në fazën inicuese, ka raste kur i dyshuari nuk ka mbrojtës dhe për këtë arsye prokurori publik i cili e inicon fillimin e procedurës për marrëveshje për pranimin e fajësisë duhet ta udhëzojë apo ta vë në dijeni të dyshuarin se ai patjetër duhet të zgjedhë një avokat. Nga kjo rrjedh se i dyshuari mund të mos ketë mbrojtës vetëm në fazën e parë, fillestare – faza inicuese, e cila i paraprin procedurës për marrëveshje për pranim të fajit, kurse prej momentit që do të fillojnë bisedimet lidhur me arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë i dyshuari doemos duhet të ketë mbrojtës, pasi që mbrojtësi ka një rol të rëndësishëm në procedurën e bisedimit për të arritur marrëveshjen.³³

Nga mbrojtësi pritet profesionalizëm, ndihmë kualitative juridike dhe veprim në drejtim të mbrojtjes së interesave të të akuzuarit. Mbrojtësi duhet të jetë me përvojë, i zhdërvjellët dhe i aftë që me prokurorin të merret vesh për sanksionin që është i pranueshëm në aspekt të mbrojtjes, duke pasur parasysh faktin se çfarë do të ishte sanksioni, në qoftë se do të realizohej procedura e rregullt penale. Duke i pasur parasysh këto pritje nga mbrojtësi është plotësisht e qartë se ligjvënësi është përcaktuar për zgjidhje ku nuk mund të realizohet procedura për marrëveshje për pranim të fajit pa praninë e mbrojtësit. Me dispozitat që kanë të bëjnë me procedurën për marrëveshje për pranim të fajit zgjerohen mundësitë për mbrojtje të obligueshme, gjegjësisht nëse i akuzuari vet nuk zgjedh mbrojtës, atij t'i përcaktohet mbrojtësi sipas detyrës zyrtare nga ana e kryetarit të gjyqit kompetent.³⁴

³³ Калајџијев Гордан, Лажетик Гордана, Неделкова Лидија ... и др - КОМЕНТАР на Законот за кривична постапка - Скопје, ОБСЕ, 2018, f.970

³⁴ Бужаровска Гордана, Спогодување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карналас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.24

2.2.4 Mospjesëmarrja e gjykatësit në procedurën për arritjen e marrëveshjes për pranim të fajit

Ndalesa që gjykata të marrë pjesë në procedurën për marrëveshje të pranimit të fajit është theksuar në mënyrë të prerë. Ky përcaktim ka për qëllim të pamundësojë ndikim të gjyqit sa i përket përzgjedhjes së llojit dhe lartësisë së sanksionit penal dhe të potencojë rolin që prokurori publik e ka si dominus litis gjatë procedurës hetimore. Me mospjesëmarrje në procedurën për marrëveshje për pranim të fajit, gjykatësi e ruan paanshmërinë e tij si arbitër, duke e vlerësuar propozim- marrëveshjen e parashtruar për pranim të fajit në bazë të dëshmive të siguruara nga ana e prokurorisë. Fakti që gjykatësi nuk ka qasje në ecurinë e procedurës për marrëveshje për pranim të fajit është i dobishëm, meqenëse në këtë mënyrë, gjykatësi nuk ka njohuri për procesin e negociatave që i ka paraprirë nënshkrimit të propozim- marrëveshjes për pranim të fajit, ai nuk i di bisedat që janë zhvilluar në mes të prokurorit dhe mbrojtësit. Në këtë mënyrë potencohet roli i gjyqit në fazën e dytë të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit. Marrëveshja për pranim të fajit mundëson dhënie të aktgjykimit në stad më të hershëm të procedurës dhe në këtë mënyrë aktgjykimi i bazuar në propozim- marrëveshjen për pranim të fajit mund të sillet si në procedurën hetimore, po edhe në fazën e vlerësimit të akuzës. Dispozitat që kanë të bëjnë me marrëveshjen për pranim të fajit zbatohen edhe atëherë kur realizohet procedura e shkurtuar. Edhe pse nuk merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në procedurën për marrëveshje për pranim të fajit, me qëllim që të mbrohen interesat e të dëmtuarit, për të cilin me prioritet është vendimi që ka të bëjë me kërkesën pronësore-juridike, është paraparë si obligim i prokurorit publik, që së bashku me të gjitha dëshmitë e siguruara të parashtrojë detyrimisht edhe deklaratë me shkrim të nënshkruar nga i dëmtuari. Në këtë mënyrë realizohet pjesëmarrje e tërthortë e të dëmtuarit nëpërmjet prokurorit publik. Megjithatë, deklarata e dhënë nuk është garanci se kërkesa pronësore-juridike do të jetë subjekt i marrëveshjes për pranim të fajit. Siç u theksua edhe më herët, kjo varet nga pëlqimi i të akuzuarit se kërkesa

pronësore-juridike a do të jetë subjekt i marrëveshjes për pranim të fajit. Megjithatë mbetet mundësia që të drejtat e tij i dëmtuari t'i realizojë në procedurë kontestimore.³⁵

2.3 Përmbajtja e propozimarrëveshjes

Në LPP janë përcaktuar në mënyrë decide elementet e propozim-marrëveshjes për pranim të fajit, të cilat mund të ndahen në disa kategori:³⁶

- të dhëna hyrëse:
- subjekti i marrëveshjes për pranim të fajit
- deklaratat e palëve
- mënyra e kompensimit të shpenzimeve të procedurës
- pjesa përfundimtare

Pra, në LPP, neni 485 shprehimisht janë të përcaktuar elementet që duhet ti përmbajë propozimarrëveshja. Këto elemente janë:

- të dhënat për prokurorin publik, të dyshuarin dhe mbrojtësin e tij;
- përshkrimin dhe kualifikimin juridik të veprave penale të përfshira me propozimarrëveshjen;
- sanksionin e propozuar penal sipas llojit dhe lartësisë:
- llojin dhe lartësinë e kërkesës pronësore-juridike dhe mënyrën e realizimit të saj, nëse i dyshuari ka dhënë pajtim sipas nenit 484 të këtij ligji;
- deklaratën e të dyshuarit se me vetëdije dhe vullnetarisht e pranon propozimarrëveshjen dhe pasojat që dalin nga ajo;

³⁵Бужаровска Гордана, Спогудување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карнакас, Дејвид Ре) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.24,25

³⁶ Ibid f.18,19

- deklaratën nga prokurori publik dhe i dyshuari se tërhiqen nga e drejta e ankesës, nëse miratohet aktgjykim me të cilin pranohet propozimarrëveshja;
- shpenzimet e procedurës;
- nënshkrimin e prokurorit publik, të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij dhe
- datën dhe vendin e lidhjes së propozimarrëveshjes.³⁷

3. VEPRIMET QË NDËRMERREN PAS PARASHTRIMIT TË PROPOZIMMARRËVESHJES

3.1 Vlerësimi i propozimarrëveshjes

Kur gjyqit do t'i dorëzohet propozim- marrëveshja për pranim të fajit e nënshkruar nga të dyja palët fillon faza e dytë e procedurës së marrëveshjes për pranim të fajit që ka të bëjë me vlerësimin gjyqësor të propozimarrëveshjes për pranim të fajit. Duke pasur parasysh faktin se propozim- marrëveshja mund të parashtrohet qysh gjatë procedurës hetimore, në procesin e vlerësimit të propozimarrëveshjes së parashtruar, rol aktiv dhe status të gjykatësit që sjell aktgjykimin në fazën e hetimit ka gjykatësi për procedurë paraprake.³⁸

Kompetent për vlerësimin e propozimarrëveshjes, është gjykatësi i procedurës paraprake. Ky është autorizimi i vetëm që e ka gjyqtari i procedurës paraprake, sipas të cilit nëse e pranon dhe e vërteton propozimarrëveshjen, sjell vendim meritor në lidhje me çështjen penale që nga faza e procedurës hetuese, dhe aktgjykimi i sjellë bëhet i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm.³⁹

³⁷ Ligji i Procedurës Penale, neni 485

³⁸ Бужаровска Гордана, Спогудување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карнавал, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.19

³⁹ Проф. д-р Лазетик Бужаровска Гордана, проф. Калаџијев Гордан, доцент д-р Илиќ Димовски Дивна, Казнено процесно право, Скопје 2015 f.288,289

3.1.1 Seanca për vlerësimin e propozimmarrëveshjes

Neni 488 i LPP parasheh veprimet që ndërmerren sipas propozimmarrëveshjes dhe afatin e ndërmarrjes së atyre veprimeve. Sipas këtij neni, “ Në afat prej tri ditëve nga marrja e propozimmarrëveshjes, gjykatësi i procedurës paraprake cakton seancë gjyqësore për vlerësimin e propozimmarrëveshjes”⁴⁰, qëllimi i së cilës është mbrojtja e te dyshuarit nga mashtrimi apo lajthimi i tij eventual në lidhje me natyrën dhe pasojat e parashtrimit të propozimmarrëveshjes.⁴¹ Vlen të theksohet se nëse ka më tepër të dyshuar, të cilët janë të gatshëm të lidhin marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe duke marrë parasysh faktin se prokurori publik është i detyruar që me secilin prej tyre veç e veç të lidhë marrëveshje të veçantë, edhe gjykata vlerësimin e propozimmarrëveshjes së secilit prej tyre do ta bëjë në seancë të veçantë.⁴²

Propozim- marrëveshja shqyrtohet në seancë të veçantë, të cilën gjykatësi i procedurës paraprake e cakton në afat prej 3 ditësh nga pranimi i propozimmarrëveshjes për pranim të fajit. Nga afati i përcaktuar në këtë mënyrë rrjedh se ligjvënësi insiston që procedura të zhvillohet shpejt dhe në mënyrë efikase. Në seancë thirren parashtruesit e propozim- marrëveshjes për pranim të fajit, gjegjësisht palët dhe mbrojtësi. Në seancë, gjyqi fillimisht i shqyrton këto rrethana:

- vallë propozim-marrëveshja është parashtruar për pranim të fajit në mënyrë vullnetare. Vallë i dyshuari është i vetëdijshëm për pasojat juridike të pranimit të saj;
- vallë i dyshuari është i vetëdijshëm për pasojat që ndërlidhen me kërkesën pronësore-juridike, dhe
- a është i dyshuari i vetëdijshëm për shpenzimet e procedurës⁴³

⁴⁰ LPP, neni 488, paragrafi 1

⁴¹ Калајџиев Гордан, Лажетик Гордана, Неделкова Лидија ... и др - КОМЕНТАР на Законот за кривична постапка - Скопје, ОБСЕ, 2018, f.973

⁴² Ibid f.976

⁴³ Бужаровска Гордана, Спогудување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карнакас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.19

Nëse gjyqtari i procedurës paraprake vëren se ndonjëra nga rrethanat e lartpërmendura nuk është përmbushur apo i dyshuari është në lajthim në lidhje me ndonjërin prej pasojave juridike që rrjedhin nga propozimarrëveshja e parashtruar, atëherë gjyqtari i procedurës paraprake aspak nuk do të fillojë vlerësimin e përmbajtjes së propozimarrëveshjes së parashtruar dhe do ta refuzojë me vendim, me ç'rast shkresat do t'ia kthejë prokurorit publik kompetent.

Pas shqyrtimit të rrethanave të lartpërmenduar, gjykatësi i procedurës paraprake është i obliguar t'i udhëzojë palët dhe mbrojtësin:

- se mund të heqin dorë nga marrëveshja e parashtruar për pranim të fajit, deri në sjelljen e vendimit nga ana e gjyqit, me ç'rast do të konsiderohet sikur ajo fare të mos ishte dorëzuar dhe të gjitha aktet do të kthehen te prokurori publik për procedurë të mëtutjeshme; dhe
- se pranimi i propozim- marrëveshjes për pranim të fajit konsiderohet heqje dorë nga drejta për ankesë ndaj aktgjykimit të sjellë me të cilin në tërësi pranohet propozim- marrëveshja e parashtruar.

Palët mund të heqin dorë nga propozim- marrëveshja e parashtruar, me ç'rast heqja dorë mund të jetë:

- **eksplicite** – nëse prokurori publik dhe i dyshuari dhe mbrojtësi i tij heqin dorë nga propozim- marrëveshja e parashtruar deri në sjelljen e vendimit; apo
- **implicite** – nëse prokurori publik dhe i dyshuari dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës parashtrojnë kërkesë për përcaktim të sanksionit që është i ndryshëm nga sanksioni që parashihet me propozim-marrëveshjen për pranim të fajit.⁴⁴

Njëkohësisht, gjyqtari i procedurës paraprake do ti paralajmërojë pjesëmarrësit se gjatë seancës patjetër të kenë kujdes se si deklarohen në lidhje me sanksionin penal, për shkak se LPP,

⁴⁴ Бужаровска Гордана, Спогодубање на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карналас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.20

neni 488, p.3 parasheh se nëse gjatë seancës për vlerësimin e propozimmarrëveshjes pjesëmarrësit parashetrojnë kërkesë për ndryshimin e sanksionit penal nga propozimmarrëveshja, llogaritet se ato e kanë ndryshuar mendimin dhe qëndrimin e tyre sa i përket çështjes se çfarë sanksioni penal është i pranueshëm për ta, gjegjësisht do të konsiderohet se kanë hequr dorë nga propozimmarrëveshja.⁴⁵

Vendim për refuzimin e propozimmarrëveshjes, përveç rasteve të lartpërmendura, mund të silltet edhe nëse gjyqtari i procedurës paraprake vërteton se provat e marra për vërtetimin e fakteve të rëndësishme për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal nuk e arsyetojnë shqiptimin e sanksionit penal të propozuar, nga çka rrjedh se pjesëmarrësit nuk i'u janë përmbajtur normave të Kodit Penal.⁴⁶

3.2 Refuzimi i propozimmarrëveshjes

Sipas nenit 489 të LPP, gjyqtari i procedurës paraprake mund ta refuzojë propozimmarrëveshjen e parashtruar nëse "...përcakton se dëshmitë e grumbulluara për faktet me rendësi për zgjedhjen dhe përcaktimin e sanksionit penal nuk e arsyetojnë shqiptimin e sanksionit të propozuar penal, përkatësisht nëse prokurori publik, i dyshuari dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës gjyqësore kanë parashtruar kërkesë për përcaktimin e sanksionit penal të ndryshëm nga sanksioni penal i përmbajtur në propozimmarrëveshjen...".

Pra, sipas kësaj refuzimi i propozimmarrëveshjes sa i përket këtij paragrafi bëhet në rast kur gjyqtari i procedurës paraprake vlerëson se sanksioni penal i përcaktuar në propozimmarrëveshje edhe pse është në korniza të minimumit dhe maksimumit ligjor të përcaktuar është ose shumë "i butë" ose shumë "i rëndë", duke i pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të veprës penale. Ai gjithashtu ka mundësi ta refuzojë

⁴⁵ Проф. д-р Лазетик Бужаровска Гордана, проф. Калаџиџев Гордан, доцент д-р Илиќ Димовски Дивна, Казнено процесно право, Скопје 2015 f.289

⁴⁶ Ibid, f. 290

propozimmarrëveshjen për shkak të sanksionit penal për të cilin pjesëmarrësit janë marrë vesh, dhe i cili është në kornizat ligjore të përcaktuara, por rrethanat e rastit nuk e arsyetojnë atë. Propozimmarrëveshja e parashtruar mund të refuzohet nga ana e gjykatës edhe në rastet kur gjyqtari do të vlerësojë se te i dyshuari mungojnë vullneti, vetëdija dhe kuptimi i pasojave që dalin nga nënshkrimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë; në rastet kur nga provat e paraqitura nuk dalin karakteristikat e veprës penale të kryer dhe të përshkruar në propozimmarrëveshje, apo nga ato prova nuk vërtetohet se personi i dyshuar në fjalë është kryerës i veprës penale.⁴⁷

Vendimi negativ i gjyqit është në formë të aktvendimit për refuzim të propozim-marrëveshjes për pranim të fajit të cilën gjyqi do ta sjellë kur:⁴⁸

- do të vërtetohet se dëshmitë e mbledhura për faktet që janë të rëndësishme për zgjedhje dhe peshim të sanksionit penal nuk e arsyetojnë shqiptimin e sanksionit të propozuar penal të paraparë në propozim-marrëveshjen për pranim të fajit
- prokurori publik, i dyshuari dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës kanë bërë kërkesë për përcaktim të sanksionit penal që ndryshon nga ai që është paraparë në propozim marrëveshje.

Nuk lejohet ankesë kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimmarrëveshja për pranim të fajit. Në rast të sjelljes së aktvendimit me të cilin refuzohet propozim-marrëveshja për pranim të fajit, gjykatësi i procedurës paraprake ia dorëzon aktet prokurorit publik, ndërsa procesverbali nga seanca e mbajtur dhe propozim-marrëveshja për pranim të fajit nuk mund të shfrytëzohen gjatë procedurës së më tutjeshme, për shkak se ato ndahen në zarf të veçantë, të mbyllur. LPP nuk përmban asnjë lloj kufizimi sa i përket mundësisë që palët përsëri të

⁴⁷ Калајџиев Гордан, Лажетик Гордана, Неделкова Лидија ... и др - КОМЕНТАР на Законот за кривична постапка - Скопје, ОБСЕ, 2018, f.975

⁴⁸ Бужаровска Гордана, Спогодување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карналас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.21

parashtrojnë propozim-marrëveshje për pranim të fajit deri në gjyq, pasi ai paraprakisht t'ua ketë refuzuar propozim- marrëveshjen që është vlerësuar si e papranueshme.⁴⁹

3.3 Pranimi i propozimmarrëveshjes

Vendimi i gjykatësit për propozim- marrëveshjen e parashtruar mund të jetë në formë të aktvendimit, gjegjësisht në formë të aktgjykimit, varësisht nga ajo se gjykatësi a e ka vlerësuar atë si të pranueshme apo jo. Nëse propozim- marrëveshja për pranim të fajit vlerësohet si e pranueshme, gjyqi kompetent sjell aktgjykim i cili bazohet në propozim- marrëveshjen për pranim të fajit dhe gjatë sjelljes së këtij aktgjykimi gjyqi nuk duhet të shqiptojë sanksion penal të ndryshëm nga sanksioni penal që është paraparë në propozim- marrëveshjen për pranim të fajit. Nga ky përcaktim del se gjyqi nuk guxon të bëjë asnjë lloj ndryshimi në sanksionin e propozuar (dënimi kryesor dhe dënime apo masa dytësore) për se janë dakorduar palët. Nëse konsideroni se sanksioni i propozuar nuk është i pranueshëm si tërësi, sillet një aktvendim për refuzim të propozim-marrëveshjes, pas të cilit aktet kthehen te prokurori (në rast se marrëveshja për pranim të fajit bëhet gjatë procedurës hetimore) gjegjësisht vazhdohet me procedurën (nëse marrëveshja për pranim të fajit është bërë në ndonjë stad të mëvonshëm të procedurës).⁵⁰

⁴⁹ Бужаровска Гордана, Спогодување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карналас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.21,22

⁵⁰ Бужаровска Гордана, Спогодување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карналас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010 f.20

4. SJELLJA E AKTGJYKIMIT NË BAZË TË MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJËSISË

“Nëse gjykatësi i procedurës paraprake e pranon propozimmarrëveshjen, shqipton aktgjykim me të cilin nuk guxon të shqiptojë sanksion penal të ndryshëm nga sanksioni penal i përmbajtur në propozimmarrëveshje. Aktgjykimi shpallet menjëherë, ndërsa përgatitet me shkrim në afat prej tri ditësh nga dita e shpalljes. Aktgjykimi pa prolongim i dorëzohet prokurorit publik, të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij. Ekzemplari nga aktgjykimi pa prolongim i dorëzohet edhe të dëmtuarit. Nëse i dëmtuari nuk është i kënaqur nga vendimi për llojin dhe lartësinë e kërkesës së gjykuar pronësore-juridike, të drejtën e vet i dëmtuari mund ta realizojë në procedurë kontestimore.”⁵¹

Nëse gjykatësi vlerëson se propozimmarrëveshja është e pranueshme do të sjellë aktgjykim në bazë të propozimmarrëveshjes, me të cilin patjetër ta shqiptojë sanksionin e njejtë penal si në propozimmarrëveshje, sepse gjyqtari i procedurës paraprake këtu nuk ka autorizim të bëjë çfarëdo lloj ndryshimesh dhe përmirësimesh, por nëse ai mendon dhe vlerëson se sanksioni penal nga propozimmarrëveshja nuk është i përshtatshëm, është i detyruar të sjellë vendim për refuzimin e propozimmarrëveshjes në pajtim me nenin 489 nga LPP.⁵²

⁵¹ Ligji për procedurë penale, neni 490

⁵² Калајџиев Гордан, Лажетик Гордана, Неделкова Лидија... и др - КОМЕНТАР на Законот за кривична постапка - Скопје, ОБСЕ, 2018, f.976

KAPITULLI III

ASPEKT KRAHASIMOR I MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJIT, ME THEKS TË VEÇANTË NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

1. MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

1.1 Nocioni dhe objekti

Sistemi i drejtësisë penale në Kosovë për zgjidhjen e çështjeve jashtë gjyqësore ka përfshirë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e cila është e autorizuar në Kodin e Procedurës Penale. Kosova ka përqafuar konceptin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe institucionalizuar atë duke ju referuar SHBA-ve. Në Kosovë, me ndryshim-plotësimet e bëra në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2008, ka hyrë si institucion i ri marrëveshja për pranimin e fajësisë ndërkaq në vitin 2013 kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi te Kodi i ri i Procedurës penale, me ndryshime më të favorshme për aplikim sa më efektiv.⁵³ Në sistemet e mëparshme shqyrtimi kryesor ishte rezultati i pritshëm i çfarëdo hetimi apo aktakuze. Mirëpo, ekzistojnë disa arsye përse prokurori i shtetit apo i pandehuri kërkojnë alternativa, dhe gjykata duhet t'i mbështesë ato alternativa. Arsyeja e parë përse prokurori i shtetit kërkon alternativa është avancimi i hetimeve, pasi që marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund të rezultojnë në atë që i pandehuri të bëhet dëshmitar bashkëpunues. Në këtë mënyrë, i pandehuri mund të sigurojë prova shtesë kundër personave tjerë të cilët kanë kryer vepra penale dhe në këtë mënyrë të avancojë në hetimet e tij/saj. Ky është mjet i rëndësishëm për hetimet e ndërlikuara, veçanërisht për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Një arsye tjetër për të kërkuar alternativa tjera është mbrojtja e viktimës nga ripërjetimi i asaj nëpër të cilën ka kaluar në gjykatë, gjë që mund të jetë përvojë

⁵³Jupolli Edina, JUSTICIA - Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar Viti VI, Nr 6/2016-2018, Prishtinë, 2018 f.83

traumatike dhe e vështirë. Alternativat gjithashtu mund të sigurohen nëse i pandehuri kërkon trajtim në vend të dënimit.⁵⁴

Me qëllim të lehtësimit të punëve në sistemin e drejtësisë penale, e cila është fushë e ndjeshme dhe tejet serioze, Republika e Kosovës ka përcaktuar me ligj dhe po e aplikon institucionin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Marrëveshja e shkruar në mes të personit ndaj të cilit është ngritur aktakuza e deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor dhe Prokurorit të shtetit me ç'rast pranohet fajësia për veprën penale, nën kushte të caktuara që Prokurori shtetit të tërhiqet nga disa pika të aktakuzës, të përcaktojë kufijtë e zbutjes së dënimit ose të tërhiqet në tërësi nga dënimi në rast se i akuzuari pranon të jetë dëshmitarë bashkëpunues. Në këtë rast pranimi i tillë ndikon që personat tjerë të pengohen në kryerjen e veprës penale ose të provohet se kanë kryer vepra penale dhe kjo paraqet objektin thelbësor të marrëveshjes për pranim të fajësisë. Kësisoj, marrëveshja për pranimin e fajësisë është institucion i së drejtës së procedurës penale i cili në vete gërsheton çështje të karakterit procedural dhe material penal. Me fjalë të tjera, marrëveshja për pranimin e fajësisë i ofron mundësinë të akuzuarit që në këmbim të pranimit të fajësisë të përfitoj lehtësira në aspektin e caktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal.⁵⁵

Marrëveshja për pranimin e fajësisë sipas neni 233 parag. 1 dhe 2 nënkupton negociimin e kushteve të marrëveshjes me shkrim për pranimin e fajësisë ndërmjet prokurorit të shtetit dhe të pandehurit, në bazë të së cilës i pandehuri dhe prokurori i shtetit pajtohen për akuzat e përfshira në aktakuzë, ndërkaq i pandehuri pajtohet të pranojë fajësinë në shkëmbim për pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënim më të butë, ashtu siç parashihet me ligj ose të merr parasysh konsiderime të tjera në interes të drejtësisë.⁵⁶ Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e cila mund të referohet edhe si institut është një zgjidhje legjislative e re, me të cilën sigurohet zgjidhja e rasteve penale në kohën optimale nëpërmjet një

⁵⁴ Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, 2013, f.67

⁵⁵ Buzhala Ramiz, Krasniqi Kujtim, Marrëveshja për pranimin e fajësisë, f. 59

⁵⁶ Sahiti Ejup, Murati Rexhep, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013, f.32

procedure e cila thjeshton dhe shkurton gjykimin penal, në të cilën parashihet të përfitojnë të dyja palët. Për më tepër, kjo marrëveshje për pranimin e fajësisë vlenë pothuajse në cilën do fazën, që do të thotë gjenë zbatim para ose pas ngritjes së aktakuzës, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë. Negocimi për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë mund të kërkohet nga mbrojtësi i të pandehurit ose të inicohet nga prokurori i shtetit. Në të dyja rastet kjo kërkesë duhet të miratohet nga kryeprokurori i zyrës përkatëse për të filluar negociatat për marrëveshjen për pranimin e fajësisë. Pasi kërkesa të miratohet nga kryeprokurori i shtetit të zyrës përkatëse të tij, prokurori i shteti ka dy alternativa të cilat ia ofron mbrojtësit të të pandehurit, 1. dërgon letër marrëveshjen e ofruar me kushtet e përcaktuara, dhe 2. takon mbrojtësin dhe të pandehurin për të negociuar kushtet dhe mundësitë e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Marrëveshja e arritur mbi pranimin e fajësisë duhet të jetë e nënshkruar nga prokurori, kryeprokurori i zyrës përkatëse, mbrojtësi dhe i pandehuri si dhe duhet të jetë detyruese për të gjitha palët nënshkruese.⁵⁷

1.2 Marrëveshja për pranimin e fajësisë në aspektin e të Drejtës së Procedurës Penale

Kodi i Procedurës Penale në fuqi në nenin 233 parasheh marrëveshjen për pranimin e fajësisë në procedurën penale. Kështu, sipas tij: *“Në çdo kohë para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri dhe prokurori i shtetit pajtohen për akuzat e përfshira në aktakuzë dhe i pandehuri pajtohet të pranojë fajësinë në shkëmbim për:*

- pajtimin e prokurorit të shtetit që t’i rekomandojë gjykatës dënim më të butë, por jo nën minimumin e paraparë me ligj ose minimumin e përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni; ose

⁵⁷ Jupolli Edina, JUSTICIA - Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar Viti VI, Nr 6/2016-2018, Prishtinë, 2018 f.85

- konsiderime tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi sipas nenit 234 të këtij Kodi.”⁵⁸

Në rastet kur dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me prokurorin , mbrojtësi i të pandehurit, ose i pandehuri nëse nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, kërkon një takim paraprak me prokurorin e shtetit për të filluar negociimin për marrëveshjen për pranim të fajësisë, dhe në të gjitha këto negociata i akuzuari duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni. Prokurori i shtetit pas pranimit të kërkesës nga i akuzuari për takim preliminar do të informojë kryeprokurorin e zyrës së tij i cili do të jep autorizim për mbajtjen e takimit të tillë. Marrëveshje të tilla mbi pranimin e fajësisë duhet të jenë të shkruara dhe të pranuar nga kryeprokurori i zyrës përkatëse të prokurorisë para se formalisht ti ofrohen të akuzuarit. Ndërkaq, gjykata nuk mund të merr pjesë në negociimin e pranimit të fajësisë, por ajo sipas nevojës mund të caktojë afatet të arsyeshme kohore për të përfunduar marrëveshja e ma së gjati deri 3 muaj, në mënyrë që të mos zvarritet zgjidhja e çështjes penale.⁵⁹

1.3 Përmajtja dhe negociimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

Alternativa më e rëndësishme ndaj gjykimit është negociimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë sipas nenit 233. Ajo vlen për cilindo të pandehur. I pandehuri mund të bëjë marrëveshje për pranimin e fajësisë në pothuajse cilëndo fazë. Ndryshe nga kodi i mëparshëm, marrëveshja për pranimin e fajësisë mund të bëhet para ose pas ngritjes së aktakuzës, bile edhe gjatë shqyrtimit kryesor.⁶⁰

⁵⁸ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë.

⁵⁹ Buzhala Ramiz, Krasniqi Kujtim, MARËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË, f. 60,61

⁶⁰ Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, 2013, f.68

Marrëveshja për pranimin e fajësisë duhet të përpilohet me shkrim pasi që përbën dokument formal dhe zyrtar dhe është e detyrueshme për palët. Marrëveshja si e tillë duhet të përmbajë të gjitha kushtet e marrëveshjes e cila duhet të jetë e nënshkruar nga kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, mbrojtësi dhe i akuzuari, dhe është detyruese për të gjitha palët nënshkruese.

Marrëveshja mbi pranimin duhet së paku të përfshijë:

1. Pikat e aktakuzës për të cilat i akuzuari e pranon fajësinë;
2. A pranon i akuzuari të bashkëpunojë;
3. Të drejtat nga të cilat hiqet dorë;
4. Përgjegjësinë e të akuzuarit për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar dhe konfiskimin e të gjitha të mirave materiale në pajtim me nenet 489-499 të KPP.

Marrëveshja me shkrim po ashtu mund të përfshijë dispozitën me të cilën palët pajtohen për kufijtë e dëmit që do të propozohen nga ana e prokurorit publik nëse i akuzuari bashkëpunon substancialisht, ndërsa nëse gjykata cakton dënim i cili dëmton një palë, pala do të ketë të drejtë ankese kundër vendimit mbi dënimin. Sipas kësaj zgjidhje, marrëveshja e arritur për pranimin e fajësisë duhet të jetë e përpiluar me shkrim si dhe të përmbajë të gjitha kushtet mbi të cilat janë pajtuar palët. Përveç kësaj, marrëveshja e tillë, për të qenë valide duhet të nënshkruhet nga kryeprokurori i prokurorisë përkatëse si dhe i akuzuari dhe mbrojtësi i tij. Si e tillë kjo marrëveshje e arritur është e detyrueshme për palët. Pra, palët nuk mund të pranojnë marrëveshjen e arritur në pjesë të caktuara e në pjesët tjera jo. Ajo i obligon palët në tërësinë e saj. Ky është aspekti parimor i përmbajtjes së marrëveshjes. Kjo do të thotë se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë mund të fokusohet në përmbajtjen e vetëm të dhënave që konsiderohen të domosdoshme.⁶¹

Në rastet kur i pandehuri dëshiron të arrijë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, mbrojtësi i të pandehurit kërkon një takim me prokurorin e shtetit me qëllim të fillimit të negociimit të kësaj

⁶¹ Buzhala Ramiz, Krasniqi Kujtim, Marrëveshja për pranimin e fajësisë, f.61,62

marrëveshje. Pas pranimit të kërkesës, prokurori i shtetit informon kryeprokurorin e zyrës së tij përkatëse, i cili jep autorizimin me shkrim për mbajtjen e takimit që ka për qëllim të diskutoj mbi pranimin e fajësisë, në të cilin deklaratave të të pandehurit i ipet imunitet i kufizuar, që do të thotë se këto deklarata nuk mund të përdoren si prova të pranueshme në shqyrtimin gjyqësorë, nëse marrëveshja nuk pranohet nga gjykata.⁶²

Të gjitha format e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, duhet të jenë në formë të shkruar dhe të pranuar nga kryeprokurori i zyrës përkatëse të prokurorisë, para se ato ti ofrohen të pandehurit formalisht. ⁶³

Sipas paragrafit 5 të nenit 233 të KPP, në rastet kur prokurori i shtetit dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, ai merr miratimin e kryeprokurorit të zyrës së tij përkatëse për të filluar negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Pas miratimit nga kryeprokurori i zyrës së tij përkatëse, prokurori i shtetit i dërgon letër mbrojtësit të të pandehurit në të cilën përshkruhet marrëveshja e ofruar, përfshirë kushtet e përcaktuara në paragrafin 12. të këtij neni ose takohet me mbrojtësin dhe të pandehurin për të negociuar mundësinë dhe kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë mund të arrihet në çdo periudhë para ngritjes së aktakuzës ku prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e kësaj marrëveshje të shkruar në bazë të së cilës i pandehuri pranon fajësinë në shkëmbim për: Pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënimin më të lehtë, por jo të jetë nën minimumin e paraparë me ligj, apo sipas paragrafit 7 i cili përcakton minimumin e dënimit si mëposhtë ⁶⁴:

a) Të arritur në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri mund të denohet së paku 90 % të minimumit të dënimit të përcaktuar me Kodin Penal

⁶² Ligji NR.03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale

⁶³ Ibid

⁶⁴ Jupolli Edina, JUSTICIA - Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar Viti VI, Nr 6/2016-2018, Prishtinë, 2018 f.88

b) Të arritur para shqyrtimit gjyqësor i pandehuri mund të dënohet sëpaku 80% të minimumit të dënimit të përcaktuar me Kodin Penal

c) Të arritur para shqyrtimit gjyqësor kur i pandehuri është dëshmitarë bashkëpunues si dhe siguron prova në procedurë penale mund të dënohet së paku 60% të minimumit të dënimit të përcaktuar me Kodin Penal.

d) Të arritur para shqyrtimit gjyqësor kur i pandehuri është dëshmitarë bashkëpunues në hetim të fshehtë dhe siguron prova mund të dënohet së paku 40% të minimumit të dënimit të përcaktuar me Kodin Penal.⁶⁵

1.4 Vendimet e gjykatës

Marrëveshja përfundimtare me shkrim i paraqitet gjykatës në seancë dëgjimore të hapur për publik, dhe në rastet kur i pandehuri vendosë të jetë dëshmitarë bashkëpunues gjykata mund të urdhëroj që seanca dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të jetë e mbyllur për publik. Gjykata, zyrtarisht mund të pranoj apo refuzoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Gjykata, poashtu gjatë shqyrtimit nëso do të duhet të pranohet apo jo marrëveshja duhet të marrë personalisht në pyetje të akuzuarin, mbrojtësin e tij, dhe prokurorin e shtetit, në mënyrë që të përcaktoj nëse këto kushte janë pëmbushur: ⁶⁶

a) I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;

b) Pranimi i fajësisë është bërë vullentarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë;

⁶⁵ Ligji NR.03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale

⁶⁶ Jupolli Edina, JUSTICIA - Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar Viti VI, Nr 6/2016-2018, Prishtinë, 2018 f.91

c) Pranimi i fajësië mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë, apo me provat materiale të paraqitura nga prokurori për plotësimin e aktakuzës dhe të pranuar nga i pandehuri, si dhe me dëshmi tjera siç mund të jenë deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura nga prokurori apo i pandehuri.

Sipas nenit 233 parag. 16 të KPP, marrëveshja për pranimin e fajësisë kontrollohet nga gjykata ashtu që ajo zyrtarisht mund ta pranojë apo refuzojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Me rastin e marrjes së njërit prej vendimeve të mësipërme gjykata shikon nëse janë përmbushur kushtet nga paragrafi 18 i nenit 233. Në të vërtetë, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë do të konsiderohet se ka hyrë në fuqi vetëm pasi të jetë evidentuar në procesverbal se gjykata marrëveshjen e ka pranuar zyrtarisht. Si mund të shihet, arritja e formës së prerë, sikurse të vendimet dhe aktet të tjera është kusht themelor për të proceduar më tutje me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.⁶⁷

Në paragrafin 20 të këtij neni, rregullohet procedura e refuzimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Ndonëse gjykata nuk është pjesë e marrëveshjes mbi pranimin fajësisë sipas KPP-së, ajo megjithatë është e autorizuar, siç theksuam më parë, të përcaktojë nëse janë përmbushur kushtet e parapara në parag. 18 të këtij neni për arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Kështu, në rastet kur këto kushte sipas mendimit të gjykatës nuk janë përmbushur në tërësi, gjykata e refuzon pranimin fajësisë. Refuzimin e marrëveshjes nga ana e gjykatës duhet kuptuar si dështim para se gjithash të palëve për përmbushjen e kushteve për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Në të tilla raste, çështja penale duhet të procedohet në shqyrtim gjyqësor ashtu siç parashikohet me dispozitat përkatëse të KPP-së.⁶⁸

Derisa në paragrafin paraprak të këtij neni përcaktohen kushtet në të cilat gjykata mund të refuzojë marrëveshjen për pranimin e fajësisë, në paragrafin 21 të nenit 233, përcaktohen kushtet nën të cilat gjykata mund ta pranojë marrëveshjen. Kështu, në rastet kur gjykata bindet se janë plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara në paragrafin 18, ajo mund ta pranojë

⁶⁷ Sahiti Ejup, Murati Rexhep, Elshani Xhevdet, Komentari Kodi i Procedurës Penale i RKS, f.597,598

⁶⁸ Ibid f.602

marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe njëkohësisht të urdhërojë që marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë. Detyrimin e gjykatës për të evidentuar marrëveshjen në procesverbal bashkë me detyrimin tjetër të gjykatës për ta vendosur marrëveshjen për pranimin e fajësisë, në shkresat e lëndës, duhet konsideruar si veprime me të cilat bëhet pranimi zyrtar i marrëveshjes nga ana e gjykatës me çka njëherësh marrëveshja edhe hyn në fuqi. Pasi që marrëveshja të jetë pranuar, gjykata do ta caktojë një datë (termin) kur palët do të japin deklaratat e tyre lidhur me dënimin dhe më pas gjykata shqipton dënimin. Megjithatë, në rastet kur në arritjen marrëveshjes mbi pranimin fajësisë merr pjesë edhe i pandehuri bashkëpunues, duke pas parasysh qëllimin e institutit të dëshmitarit bashkëpunues, gjykata mund ta shtyjë datën e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit vetëm e vetëm që i akuzuari të mundë të shërbejë gjykatës edhe më tutje si dëshmitar bashkëpunues. Në bazë të kësaj që tha më sipër, mund të përfundohet se shqyrtimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë nga ana e gjykatës mund të ndahet në dy etapa: e para në të cilën bëhet pranimi përkatësisht refuzimi dhe e dyta në të cilën bëhet caktimi i dënimit.⁶⁹

1.4.1 Shembuj dhe analizë të aktgjytimeve të sjella në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në Gjykatat themelore në Kosovë

Në këtë pjesë të punimit tim të magistraturës do të paraqes shembuj të aktgjytimeve të sjella në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në gjykatat themelore në Kosovë, konkretisht aktgjytime të sjella në gjykatat themelore Prizren , Gjilan dhe Gjakovë. Qëllimi kryesor i vendosjes së këtyre shembujve të aktgjytimeve është që të paraqes se si duket një aktgjykim i sjellë në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajit dhe njëkohësisht t'i kushtoj vëmendje çështjes se për vçilat vepra penale janë sjellë këto aktgjytime dhe çfarë dënime janë shqiptuar.

⁶⁹ Sahiti Ejup, Murati Rexhep, Elshani Xhevdet, Komentari Kodi i Procedurës Penale i RKS, f.602

1.4.1.1 Aktgjykimi P.nr.1175/2019 (Gjykata themelore Prizren)

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

P.nr.1175/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike, procesmbajtëse AA , në lenden penale kundër të akuzuarit kundër të akuzuarit F.H, nga fshati ..., komuna e ..., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (KPRK), sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1458-3/2019 të datës 06.09.2019, pas mbajtjes së seancës për marrveshjen për pranimin e fajësisë, në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren, S.B, të akuzuarit, mbrojtësëve të tij avokat S.M dhe avokat M. Sh, me date 26.09.2019 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.H, nga i ati A.dhe nëna Sh. e lindur Z., i lindur me datë në fshatin, komuna e ..., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, tregëtar, i martuar, baba i ... fëmiu, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 08.07.2019, rreth orës 16,15 minuta, në, në rrugën “.....”, në parkingun e “.....”, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, ia merr pasurinë të dëmtuarit D.R, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e volitshëm, largimin e të dëmtuarit nga automjeti, me përdorimin e forcës thyen xhamin e derës automjetit të markës “...”, ngjyrë hiri, me terga gjermane dhe nga aty merr çantën e krahut ngjyrë e kaltër të markës “...”, në të cilën kishte një dëgjuese +7, adapter për telefonin +7 dhe kablli i telefonit ngjyrë të kuqe dhe largohet nga vendi i ngjarjes

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 të KPRK-ës.

PRANOHET MARRËVESHJA për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorit të shtetit pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, - Departamenti i përgjithshëm dhe të akuzuarit F.Hj, në prezencën e mbrojtësve të tij avokat S. M dhe avokat M. Sh, PP/II.nr.14583/2019 të datës 05.09.2019, për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 të KPRK-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 38, 39, par.1. pika 1.1, 40, 49 par.1 pika 1.2 dhe 1.3, 42, 43, 69, 70, 71, 72, dhe 315 par.1 nën par.1.1 të KPRK-ës. I shqipton

DENIM ME GJOBË

Në lartësi prej 900 (nëntëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi,

Në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, gjykata dënimin me gjobë do të zëvendësoj me dënim me burg, duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 45 ditë burg; dhe

DËNIM ME BURG

Në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burgim, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.07.2019, e deri në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit,

Po ashtu obligohet i akuzuari të paguaj në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumën prej 20,00 Euro, si dhe në emër të mbrojtjes të viktimave shumën prej 30,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë e këtij aktgjykimi, nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari R(R) R, nga ..., rruga "...", nr...., për realizimit e kërkesës pronësoro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr.14583/2019 të datës 06.09.2019, kundër të akzuarit F.H, nga fshati e epërme, komuna e, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (KPRK)

.....

Gjithashtu Prokuroria Themelore në Prizren, sipas aktakuzës PP/II.nr.1458-3/2019 të datës 06.09.2019, ka parashtruar gjykatës marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe të akuzuarit. Po ashtu i akuzuari është njoftuar që nëse gjykata pranon fajësinë, e njëjta nuk mund të tërhiqet më vonë, dhe nëse i shqipton dënim të marrëveshjes do të jetë shumë vështirë nga ana e të njëjtit të sfidohet shqiptimi i dënimit, në fund i akuzuari deklaroi që e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe se pranon fajësinë si në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të datës 05.09.2019

Gjykata është e bindur se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin 18 të nenit 233 të KPP-ës, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe pas përfundimit të dëgjimit në shqyrtimin gjyqësor i ka shqiptuar të akuzuarit për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 të KPRK-ës, dënim me gjobë në shumë prej 900 (nëntqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, Në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, gjykata dënimin me gjobë do të zëvendësoj me dënim me burg, duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 45 ditë burg dhe dënim me burg, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burgim, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.07.2019, e deri në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit,

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.1175/2019 me datë 26.09.2019

Procesmbajtësja

Gjyqtari

AA

BB

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

1.4.1.2 Aktgjykimi PKR.nr.56/2017 (Gjykata themelore Gjakovë)

PKR.nr.56/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,—Departamenti për Krime të Rënda, Gjyqtarit S.Z, Kryetari i Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen e sekretares juridike B.R, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. S. K., nga T. R. Shqipërisë, tani me banim te përkohshme ne fshatin Zh. K- Gjakovë, për shkak te veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve te rrezikshëm substancave psikotrope nga neni 273 prg 2 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Gjakovë, - Departamenti për Krime të Rënda PP/l.nr. 1/2017, te dt. 18.05.2017, pas mbajtjes se seancë të shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të mbajtur më dt.05.06.2017, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurores së Shtetit Shpresa Bakija, i akuzuari F. K., dhe mbrojtësi te tij av. P. P nga Gjakova, i caktuar sipas Detyrës Zyrtare, me datë 05.06.2017 muar dhe publikisht shpalle këtë :

A K T G J Y K I M

1.I akuzuari: F. K., nga T. R. Shqipërisë, tani me banim ne fshatin Zh. K- Gjakovë, nga i ati S. dhe ëma F. e gjinisë B., i lindur me dt., ku dhe jeton, i pa martuar, i pa pune, i gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptar Shtetas i R. Shqipërisë, gjendet ne paraburgim prej dt. 06.05.2017.

ËSHTE FAJTOR

Pasi pa autorizim është furnizuar me substancë narkotike te llojit “ marihuana” e cila me ligj është shpallur si narkotike, këtë substancë e ka shitur te akuzuarve A. Sh., dhe S. D., në shume prej 45 €, dhe dy pako cigare, ne atë mënyrë që natën kritike me dt. 03.01.2017, rreth orës 23:20 min, në fshatin Zh. K- Gjakovë, nga patrulla e Policisë DRPK- Perëndimi ne Gjakovë është vërejtur një automjet i ndaluar i tipit “ Volsfagen Passat” me ngjyre te kuqe,

me tabela ... ne të cilin automjet ndodheshin te pandehurit A. Sh., dhe S. D., dhe pas kontrollit dhe bastisjes se personave dhe automjetit ne afërsi te ulëses se pasagjerit tek pjesa e këmbeve janë gjetur dhe sekuestruar 2 qese plasmasi njëra me mbishkrimin Viva Fresh Store, dhe tjetra Meridian, në të cilat brenda kishin substancë narkotike qe sipas raportit mbi ekzaminim Nr. AKF- 2017-135/2017- 127, te dt. 02.02.2017, ka rezultuar se është e llojit “ marihuana” ne peshe të përgjithshëm prej 1.356, 52 gr. te cilën substancë narkotike te pandehurve gjere te automjeti i tyre i kishte sjellur i pandehuri F. K., dhe shoku i tij, te cilat me te vërejtur policinë janë larguar ne drejtim te pa njohur.

- me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikut të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 273 prg 2 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 3, 6, 17, 21, 41, 43, 45, 73, neni 273 prg 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe neneve 359 par. 2, 366,450,458 te KPPK-se te akuzuarin i shqipton:

DENIMIN ME BURG DHE GJOBË

Për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikut të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 273 prg 2 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, në të cilin dënim do te llogaritet koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 06.05.2017, i cili paraburgim është vazhduar gjerë në plotfuqishmëri e këtij aktgjykimi, i cili nuk mund te zgjas me shume se dënimi i shqiptuar ne këtë aktgjykim, si dhe dënimi me gjobe 700 (shtatë qind)€, i cili dënim duhet të paguhet ne afate prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, po qe se dënimi me gjobe nuk do te paguaj i njëjti dënim do te zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 35 (tridhjetë e pesë) dite, duke llogaritur për çdo dite te burgimit shumën prej 20(njëzete)€.

I akuzuari F. K., obligohet që ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa do te jenë sipas llogarisë së kësaj Gjykate, dhe ne emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30(tridhjetë)€, te gjitha këto ne afate prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjakove, - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr. 1/2017, te dt. 18.05.2017, kundër te akuzuarit F. S. K., nga T. R. Shqipërisë, tani me banim ne fshatin Zh. K- Gjakovë, p.nr. për shkak te veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve te rrezikshëm substancave psikotrope nga neni 273 prg 2 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se. Me propozim për caktimin e seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Gjykata ka caktuar seancës dëgjimore të shqyrtimit te marrëveshjes për pranimin e fajësisë ku prezent kanë qene përfaqësuesin e Prokurorisë Themelore ne Gjakove, Prokurorja e Shtetit S.B, i akuzuari F. K., si dhe mbrojtësi i tij av.P. P., i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Gjykata gjate seancës dëgjimore të shqyrtimit te marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka dëgjuar përfaqësuesin e akuzës Prokuroren e Shtetit, te akuzuarin dhe mbrojtësin e tij.

Prokurorja e shtetit S.B, ka deklaruar se mbrojtësi i të akuzuarit F. K., av. P. P., Prokurorisë Themelore në Gjakovë, - Departamentit për Krime të Rënda, i ka parashtruar kërkesën për negociimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe pas negociimit te marrëveshjes marrjes se pëlqimit nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore ne Gjakovë, me te akuzuarit dhe mbrojtësin e tij kemi arritur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe atë pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e të akuzuarit kështu qe kjo marrëveshje është nënshkruar nga te gjitha palët ne procedurë e për të cilën marrëveshje për kushte llojin e dënimit është njoftuar Gjykata si dhe vete i akuzuari andaj i ka propozuar Kryetarit te Trupit Gjykuese qe këtë marrëveshje te aprovoi.

.....

I akuzuari F. K., ne tërësi ka ngelur pranë marrëveshjes se arritur ne mes te Prokurorit te Shtetit dhe mbrojtësit te tij, duke theksuar se mbrojtësi i tij i ka shpjeguar te gjitha te drejtat ligjore dhe të njëjtën marrëveshje e ka nënshkruar me vullnetin e tij personale pa ndikim te askujt.

.....

Andaj, Gjykata ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elemente qenësore te veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve substanca psikotrope dhe analoge nga neni 273 prg 2 si bashkë kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, të përshkruar si ne dispozitiv I, te këtij aktgjykimi, dhe për këtë ka vendosur qe te pranoi fajësinë e të akuzuarit dhe te akuzuarin ta shpalli fajtores dhe ta dënoi ne baze te Ligjit.

Gjate seancës për caktimin e dënimit Prokurori i Çështjes ka deklaruar se: mbetet pranë dënimit te rekomanduar ne marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, për të akuzuarin F. K., për vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve te rrezikshëm substancave psikotrope nga neni 273 prg 2 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, ku për ketë vepër penale është parapare dënimi prej 2 deri 12 vite, dhe konsideroi se dënimi i propozuar ne marrëveshje, ne kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, gjere ne 9 (nëntë) muaj burgim si dhe dënim me gjobe prej 600 (gjashte qind) deri në 800 (tetë qind)€, është ne përputhshmëri ne veprën penale për të cilën akuzohet i akuzuari dhe mendojmë se në këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me Ligj.

I akuzuari F. K., ka deklaruar se: e mbështet fjalën e mbrojtësit te tij, dhe pendohet për veprën e kryer dhe shpreh keq dhe premtion qe ne te ardhëm nuk do te kryej vepra te ngjashme penale.

Gjykata duke vendosur mbi sanksionin penale juridike te propozuar ne marrëveshje ka vlerësuar te gjitha rrethanat konform nenit 73 te KPRK-se, qe ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu qe si rrethanë lehtësuese për te akuzuarin ka marrë pranimin i fajësisë nga ana e tij, pendimin e tij, për veprën e kryer qëndrimin i tij korrekte gjate gjykimit, jo dënueshme rinë e tij, moshën e tij te re, ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata pati parasysh peshën dhe natyrën e kësaj vepre penale si ky lloji i veprës penale paraqet rrezikshmëri te larte shoqërore, dhe këto

vepra penale ne territorin e kësaj Komune janë ne rritje e sipër, andaj Gjykata të njëjtit i ka shqiptuar dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 7(shtatë) muajve, si dhe dënim me gjobe ne shume prej 700 (shtatë qind)€, me shpresë dhe bindje se dënimi i shqiptuar do te arrin qëllimet e dënimit te parapare me dispozitat te nënti 41 te KPK-se.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe ne emër te paushallit gjyqësor bazohet ne dispozitat e nenit 450 par 3 të KPPK-se.

Nga arsyet e cekura me larte dhe me zbatimin e neni 365 par. 1 te KPPK-se është vendosur ne dispozitave te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË, - Departamenti për krime të Renda, PKR.nr.56/2017,
dt. 05.06.2017

Procesmbajtësja

Kryetari i trupit gjykues

B.R

S.Z

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund te parashtrohet ankesë, nëpër mjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtine ne afati prej 15 ditëve nga dita e pranimit te aktgjykimit.

1.4.1.3 Aktgjykimi PKR.nr.164/2019 (Gjykata themelore Gjilan)

Numri i lëndës: 2019:184815 Datë: 22.11.2019 Numri i dokumentit: 00669381

PKR.nr.164/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, departamenti për të mitur, përmes gjyqtarit për të mitur, S.B, me zyrtares ligjore H.V si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit, L.B. nga fshati L... , komuna e Kamenicës të cilin sipas autorizimit e mbron av. S.S. nga Kamenica për shkak të veprës penale, ngacmimi seksual nga neni 183 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (në tekstin e mëlutjeshëm KPKK-ës), sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan (në tekstin e mëlutjeshëm PTHDKR) PP.I.nr .147 /2019 të datës 14.10.2019 të cilën e përfaqëson prokurorja R.B ,pas mbajtjes së seancës për negociimin e marrëveshjen për pranimin e fajësisë të datës 19.11.2019, në të njëjtën ditë mori ndërsa me datën 21.11.2019 shpalli, kurse me datën 22.11.2019 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari, L.B. L.B. nga babai Z. dhe nëna M., e lindur H., i lindur me datën...në Gjilan, me vendbanim në fshatin L..., Komuna e Kamenicës, ka të kryer shkollën e mesme drejtimi “Auto Mekanik”, i pa martuar, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 12.08.2019 rreth orës 09.15 min., në lagjen “Malësia” në Kamenicë , e ka ngacmuar seksualisht, tani të dëmtuarën-të miturën O.J. e moshës 14 vjeqare e lindur më datën 24.11.2004, në atë mënyrë që pasi janë njoftuar nëpërmes rrjetit social Instagram para dy viteve i kanë vazhduar bisedat, ndërsa me datën e lartë përmendur janë takuar te lagjja “Malësia” dhe

kanë ecur përpjetë dhe në një moment kanë hyrë në mal-pisha, ku kanë qëndruar nga ora 10.00 e mëngjesit e deri në ora 13.00, ku gjatë asaj kohe i pandehuri e ka shfrytëzuar pozitën e saj të ndjeshme për shkak të moshës dhe me veprim të drejtëpërdrejt duke e prekur me duar, duke e përqaftuar, e puthur në faqe edhe pse e ka ditur se e dëmtuara është e moshës së mitur.

-me këtë ka kryer veprën penale ngacmimi seksual nga neni 183 paragrafi 1 të KPRK-së.

Numri i lëndës: 2019:184815 Datë: 22.11.2019 Numri i dokumentit: 00669381

2019:232942

Gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve të lart cekura si dhe nenet 4, 40, 42, 44, 69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës si dhe nenit dhe 233 dhe 365 të KPP-ës, të pandehurin Lirigzon Bunjaku e,

GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtë dhjetë) ditësh, të cilin dënim i akuzuari detyrohet ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita vijuese kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

E pas shpalljes së aktgjykimit me pëlqimin e deklaruar shprehimisht të pandehurit , ky dënim i shqiptuar me burgim në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, i

ZËVENDËSOHET ME DENIM GJOBË

Në shumën prej 300 (treqind) €, të cilin dënim i pandehuri detyrohet që ta paguaj në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita vijuese kur ky aktgjykim i plotfuqishëm . Mirëpo në qoftë se i akuzuari nuk e paguan ose nuk dëshiron që ta paguaj dënimin me gjobë, në atë raste i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60(gjashtëdhjetë) ditëve.

I. **DETYROHET** i akuzuari që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumë prej 25 €.

II. Shumën prej 50 € në emër të kompensimit e viktimave të krimit . Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita vijuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

ARSYETIMI

PTHDKR. në Gjilan me datën 14.10.2019 ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr 147/2019 kundër të akuzuarit L.B. nga fshati L... , komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale, ngacmimi seksual nga neni 183 paragrafi paragrafi 1 të KPRK-ës. Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti për të mitur e ka paraqitur në gjykatë marrëveshjen për pranimin e fajësisë të nënshkruar nga prokurorja e çështjes Rabije Jakupi, i pandehuri L.B. dhe mbrojtësi i tij av. S.S. nga Kamenica me autorizim si në shkresat e lëndës. Gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë prezantuar Prokurorja e prokurorisë Themelore në Gjilan, Rabije Jakupi si dhe i akuzuari me mbrojtësin e tij, ndërsa me rastin e shpalljes së aktgjykimit nuk ka prezantuar askush nga palët.

Në seancën dëgjimore mbi negociimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të mbajtur me datën 20.11.2019 prokurorja e PTHDM. në Gjilan, Rabije Jakupi në fjalën e saj deklaroi: Do të doja që në këtë seancë ta paraqes marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP.I.nr.147/2019 të datës 14.10.2019 , e të cilën e kemi dorëzuar në gjykatë me datën 15.10.2019 , që e kemi arritur me tani të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij.

Numri i lëndës: 2019:184815 Datë: 22.11.2019 Numri i dokumentit: 00669381 2019:232942

Mbrojtësi i viktimave G.L. deklaroi: meqenëse viktimat e mitur nuk prezanton në këtë shqyrtim gjyqësor, konsideroj se duke pasur parasysh veprën penale e cila ju është vënë në barrë të

pandehurit, ne e pranojmë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ndërsa kërkojmë kompensim dëmi në emër të viktimës, për shkak të moshës së saj të ndjeshme dhe pozitës së saj gjithashtu të ndjeshme nuk ka mundur ta kuptoj veprën e cila është e ndalura me ligj.

I akuzuari L.B. deklaroi: mbetem pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të datës 14.10.2019 dhe nuk kamë tjetër se çka të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av.S.S. deklaroi: e mbështes deklaratën e të mbrojturit mbi marrëveshjen e arritur për pranimin e fajësisë. I mbrojturi im është i vetëdijshëm lidhur me atë që ka pranuar, e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, e të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës janë të pranueshme dhe për këtë i mbrojturi im është në dijeni, prandaj i propozoj gjykatës që ta pranoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

.....

I akuzuari L.B. deklaroi: mbetem në tërësi pran marrëveshjes lidhur me pranimin e fajësisë, i kërkoj falje të dëmtuarës dhe premtoj që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera të kundërligjshme.

Rrjedhimisht, gjyqtari për të mitur ka qenë i bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal dhe se nënshkrimi i

Numri i lëndës: 2019:184815 Datë: 22.11.2019 Numri i dokumentit: 00669381 2019:232942

marrëveshjes nga ana e të pandehurit është bërë vullnetarisht se pranimi i fajit është mbështetur në faktet e çështjes që i përmban aktakuza me provat e propozuara nga prokuroria.

Pra një gjendje të këtillë faktike të pa kontestueshme gjyqtari për të mitur gjeti se në veprimet e të akuzuarit L.B. ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si më lartë, andaj të njëjtin e shpalli fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Sipas bindjes së gjyqtarit për të mitur, dënimi sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi është i drejtë në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se mund të pritet që edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i paraparë në nenin 38 të KPRK. si dhe ky dënim do të ndikoj në të akuzuarin dhe personat potencial ku jetojnë dhe veprojnë që në të ardhmen të përmbahen nga kryerja e veprave tjera penale. Prandaj e aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -Departamenti për të mitur- PKR.nr.164/2019 Me datën 22.11.2019.

Zyrtare ligjore

Gjyqtari për të mitur

H.V

S.H

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, departamenti për të mitur në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit se të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

1.5 Ngjashmëritë dhe dallimet me RMV-në

Marrëveshja për pranimin e fajësisë është institut proceduralo-penal i ri, i cili si pasojë e nevojës për efikasitet dhe ekonomizim të procedurës penale është futur në legjislacionet e RMV-së dhe RKS-së relativisht vonë, përkatësisht në legjislacionin proceduralo-penal të RMV-së marrëveshja për pranimin e fajësisë është futur si institut në LPP me ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji në vitin 2010, kurse në legjislacionin penal të Kosovës ky institut është inkorporuar me ndryshim-plotësimet e bëra në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2008. Në të dy legjislacionet ka përkufizim të ngjashëm, ku definohet si: institut i ri proceduralo-penal, marrëveshje në formë të shkruar, e cila lidhet në mes të prokurorit publik, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, e që ka për qëllim që i pandehuri të përfitojë benefite të caktuara, zbutjen e dënimit por jo nën minimumin e përcaktuar ligjor. Lëndë e marrëveshjes është lloji dhe lartësia e sanksionit penal që do të propozohet në propozimmarrëveshjen, e nëse ekziston pajtim nga i dyshuari lëndë e marrëveshjes mund të jetë edhe kërkesa pronësore juridike nga i dëmtuari.

Në vija të përgjithshme të dy legjislacionet janë të ngjashëm për sa i përket marrëveshjes për pranimin e fajësisë, por ekzistojnë edhe disa dallime të vogla mes tyre. Kështu për shembull neni 486 i LPP i RMV-së parasheh detyrimin që personi i dyshuar të ketë mbrojtës nga momenti i fillimit të procedurës për marrëveshje, kurse neni 233 parag.3 i KPP i RKS, parasheh mundësinë që në rastet kur i pandehuri dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë edhe kur nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, ai mund të kërkojë nga prokurori i shtetit një takim paraprak për të filluar negociimin për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, kurse në negociatat e tilla i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.

Dallimi tjetër me RMV-në konsiston në atë se pas pranimit të kërkesës për takim paraprak, prokurori i shtetit informon kryeprokurorin e zyrës së tij përkatëse, i cili jep autorizim me shkrim për mbajtjen e takimit për diskutimet mbi pranimin e fajësisë. Të gjitha marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë duhet të jenë të pranuar nga kryeprokurori i zyrës përkatëse të prokurorisë para se formalisht t'i ofrohen të pandehurit.

Gjithashtu në RMV, në marrëveshjen për pranimin e fajësisë nuk kërkohet që i dyshuari të japë shprehimisht deklaratë se e pranon fajësinë, por kjo nënkuptohet heshtazi, kurse në Kosovë, parag.12 i nenit 233, taksativisht numëron se çka duhet të përmbajë marrëveshja për pranimin e fajësisë, ndër të cilat përmend edhe “pikat e aktakuzës për të cilat i pandehuri pranon fajësinë”. Këtë poashtu e vërejmë edhe në parag.18 ku thuhet : “Gjatë shqyrtimit se a duhet pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata duhet të dëgjoj të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe prokurorin e shtetit dhe të përcaktojë nëse: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e *pranimit të fajësisë; pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, nëse ka mbrojtës, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë; pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë, apo me provat materiale të paraqitura nga prokurori për plotësimin e aktakuzës dhe të pranuar nga i pandehuri, si dhe me dëshmi tjera, siç mund të jenë deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura nga prokurori apo i pandehuri.*

2. GJYKIMI ME MARRËVESHJE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

“Gjykimi me marrëveshje është një marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimit të dënimit. Në këtë marrëveshje merr pjesë prokurori i çështjes, i pandehuri dhe mbrojtësi. Secili nga këta të tre ka të drejtë të propozojë një marrëveshje”.⁷⁰

Marrëveshja për pranimin e fajësisë apo siç quhet ndryshe edhe Gjykimi me marrëveshje, në Shqipëri për herë të parë është parashikuar në seksionin e katërt të Kodit të Procedurës Penale, me shtimin me Ligjin nr 35/2017, në nenin 406/d. Sipas këtij neni “*Nga çasti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor, prokurori, i pandehuri, ose përfaqësuesi i tij i posaçëm mund të propozojnë arritjen e një marrëveshjeje mbi*

⁷⁰ Bani Erjon, Gjyqtari i Gjykatës së Tiranës, - <https://abcnews.al/gjykimi-me-marreveshje-caktoje-vete-denimin/> (accessed April 10, 2020)

kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit. “⁷¹ Paragrafi 2 i nenit në fjalë përcakton se për arritjen e kësaj marrëveshje paraprakisht zhvillohen bisedime, gjatë të cilëve prania e mbrojtësit të të pandehurit është e detyrueshme, kurse propozim mund të parashtrohet vetëm në qoftë se personi i dyshuar ka kryer veprë penale për të cilën ligji parashikon dënim maksimum deri 7 vjet por jo më shumë.

2.1 Përmbajtja e marrëveshjes

Kodi i Procedurës penale parasheh se marrëveshja bëhet në formë të shkruar dhe poashtu përcakton elementet që ajo duhet të përmbajë. Kështu që, sipas parag 3 të nenit 406/d marrëveshja bëhet me shkrim dhe përmban me pasojë pavlefshmërie⁷²:

- a) . përshkrimin e qartë të faktit penal, për të cilin akuzohet i pandehuri dhe cilësimin e tij juridik;
- b) deklarimin e pohimit të fajësisë nga ana e të pandehurit;
- c) llojin dhe masën e dënimit penal kryesor, dënimit plotësues, si dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre, për të cilat palët kanë rënë dakord;
- ç) disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, si dhe për konfiskimin e mjeteve e produkteve të veprës penale, sipas nenit 36 të Kodit Penal;
- d) në rastin kur është legjitimuar paditësi civil, pëlqimin e tij me shkrim për masën e shpërblimit të dëmit nga i pandehuri;
- dh) shumën e shpenzimeve procedurale;

⁷¹ Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë, neni 406/d, parag. 1

⁷² Jahaj Dritan, Abdiu Rezarta, Qordja Nertila, Ajdari Fatbardha.... – Udhëzuesi mbi Kodin e Procedurës Penale për avokatët dhe asistent avokatet, Shkup,2019, f.26,27

e) nënshkrimet e palëve dhe të mbrojtësit.

Në vijim do të paraqes një shembull të projekt akt marrëveshjes.⁷³

Projekt akt marrëveshja si dhe e gjithë praktika e saj e cila dërgohet në gjykatë për miratim.

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË T I R A N Ë

MARRËVESHJE PËR PRANIMIN E FAJËSISË NGA I PANDEHURI _____ NË KUADËR TË PROÇEDIMIT PENAL Nr. _____ TË VITIT 2018

Në Tirane, më datë ____/____/2018 _____ prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë pasi studiova materialet e proçedimit penal nr.____ të vitit 2018 konstatoj se: I PANDEHURI: _____ i biri i _____ dhe i _____ i datelindjes _____, lindur ne _____ dhe banues ne Tirane, Rruga « _____ », banese nr _____, me kombesi shqiptare dhe shtetesi shqiptare, me arsim, me gjendje gjyqesore i padenuar, me gjendje civile i martuar, hetuar me masë sigurimi të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Proçedurës Penale. AKUZUAR se ka kryer veprën penale të «Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt» të parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal. Në përputhje me nenin 406/d të Kodit të Procedurës Penale, kemi arritur marrëveshjen me kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit për sa më poshtë vijon: Ne daten 31.12.2017 shtetasi _____ ka qene duke qarkulluar me motomjetin e tij me targe AL 716 ne Rrugen “5 Maji”. Ky shtetas ka drejtuar motorrin ne gjendje te dehur. Nga verifikimi me sistemin Drager rezultoi se ky shtetas kishte perdorur alkool dhe konkretisht ne matjen e pare ka rezultuar 1.18 mg/l dhe ne matjen e dyte 1.15 mg/l. Ne afersi te nje bernerhane motorri i drejtuar nga shtetasi _____ eshte perplasur me automjetin me targe AA 429 KV prone e shtetasit _____ i cili ishte i parkuar. Nga aksidenti i ndodhur eshte demtuar drejtuesi i motorri shtetasi _____ i cili ka marre mjekim ne spital. Ne keto kushte policia gjyqesore ka

⁷³ Jahaj Dritan, Abdiu Rezarta, Qordja Nertila, Ajdari Fatbardha.... – Udhëzuesi mbi Kodin e Procedurës Penale për avokatët dhe asistent avokatet, Shkup,2019, f.26,27

bere arrestimin ne flagrante te shtetasve _____ dhe _____ duke respektuar kushtet dhe kriteret e neneve 251, 252, 253 Kodit te Procedures Penale. Arresti eshte vleftesuar si i ligjshem nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimet e dates 03.01.2018. Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr.81 date 08.01.2018 i IML Tirane (ardhur ne prokurori ne daten 16.01.2018) rezulton se demtimet e shtetasit _____ klasifikohen si rrahje (humbje te aftesise ne pune ne masen deri 9 dite). Nga këqyrja e motomjetit si dhe nga akti i ekspertimit auto-teknik rezulton se motorri që ka drejtuar _____ i plotëson kriteret e parashikuara në nenin 47/1, gërma “a” dhe 53/1, gërma “a”, “Motomjetet” të Ligjit 8378, datë 22.07.1998 (i ndryshuar) “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”. Po kështu në nenet 114 dhe 115 përcaktohen rastet, mosha dhe kategoritë lejeve të drejtimit për mjete si dhe çiklomotorrë. Në këto nene jepet klasifikimi “... motorë : Mjete me dy rrota, të destinuara për transport njerëzish, në numër jo më të madh se dy veta, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit”. Kategoria L1: mjete me dy rrota, cilindrata e motorrit (kur flitet për motorrë djegie të brëndëshme) të mos i kalojë 50 cc dhe me shpejtësi të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 50 km/h. Në rastin konkret ky motomjet ka sedile me dy ndenjësë dhe në kroskot ka të projektuar shpejtësinë 140 km/orë. Kodi Rrugor parashikon se:

Neni 52

Ciklomotorët

.....

.....Duke qenë se motorri nga këqyrja e vendit të ngjarjes si dhe nga akti i ekspertimit konsiderohet si motomjet atëhere NDALOHET drejtimi i tij ne gjendje te dehur. Për sa më sipër duke kryer veprimet e mësipërme i pandehuri _____ ka konsumuar tërësisht elementët e veprës penale të «Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt» të parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal. Fajësia në ngarkim të të pandehurit provohet nga: Procesverbali i arrestimit. Procesverbali i kontrollit personal. Procesverbali i deklarimit të shtetasit G.H. Procesverbali i sekuestros. Procesverbali i lënies në ruajtje. Procesverbali i këqyrjes së mjetit motorrik. Vendimi

autoteknik. Nga akti i ekspertimit auto-teknik. Raporti i shërbimit. Në lidhje me sa më sipër merren parasysh këto rrethana në caktimin e llojit dhe masës së dënimit ndaj të pandehurit.

- Faktin që vepra penale e kryer ka cenuar sigurinë publike të mbrojtur me Kushtetutë dhe posaçërisht nga legjislacioni penal.
- Faktin që i pandehuri është i padënuar më parë për vepra të ndryshme penale.
- Rrethanat në të cilën është kryer vepra penale si dhe pasojat e ardhura nga vepra penale.
- Gjëndjen ekonomike dhe sociale të të pandehurit.
- Moshën e të pandehurit.
- Pendimin e thellë të të pandehurit për veprën penale të kryer nga ana e tij.
- Gjithashtu, në masën e dënimit që propozojmë para Gjykatës, kemi parasysh dhe faktin, që ajo duhet të jetë në përshtatshmëri, jo vetëm me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit të saj, por dhe që të jetë e tillë që të vlejë për rehabilitimin e të pandehurit. I pandehuri _____ e pranon akuzën dhe ndihet i penduar për të. Akuza është pranuar nga i pandehuri në prani të avokatit të tij mbrojtës. _____ deklaron se ka drejtuar një makine pa patentë dhe pohon fajësinë e tij pra që ka drejtuar makine pa patentë. Në këto kushte, ndaj të pandehurit _____ është ngritur akuza për kryerjen e veprës penale të «Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt» të parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal.

I Pandehuri ka deklaruar në prani të mbrojtësit se: Se e pranon akuzën dhe e pohon fajësinë që ka drejtuar motorr pa patentë si dhe marrëveshjen e lidhur në lidhje me llojin dhe masën e dënimit. (deklarimin e pohimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, kushtet e rëna dakort për pranimin e fajësisë, caktimin e dënimit dhe mënyrën e ekzekutimit të tij). Akuza është pranuar dhe është pohuar fajësia në prani të mbrojtësit të tij. II. Bazuar në sa më sipër, meqenëse vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri parashikon një dënim në maksimum jo më shumë se 7 vjet burgim dhe çështja është në fazën e hetimit paraprak, është arritur marrëveshja mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit, si më poshtë: 1. I pandehuri _____

deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale të «Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt» të parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal. 2. I pandehuri pranon dënimin e tij 1 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe vendien ne prove te te pandehurit per 2 muaj. -I pandehuri të mos shoqërohet me persona të dënuar. -I pandehuri të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës Tiranë. 3. I pandehuri është dakort që ky vendim dënimi të ekzekutohet, menjëherë duke u paraqitur në Zyrat e Shërbimit të Provës Tiranë, në momentin e miratimit të marrëveshjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. 4. Shpenzimet procedurale në vlerën 1 000 lekë, do të paguhet nga i pandehuri. Përsa më sipër i pandehuri pranon se me vullnetin e tij të lirë, duke qenë i përfaqësuar në mënyrë të drejtë dhe efektive nga mbrojtësi, e kupton marrëveshjen dhe pasojat që vijnë prej saj. Palët nënshkruajnë rregullisht.

I PANDEHURI

MBROJTËSI

PROKUROR

2.2 Shqyrtimi i marrëveshjes nga ana e gjykatës

Me arritjen e marrëveshjes, prokurori e dërgon atë për miratim në gjykatë, së bashku me të gjitha aktet e hetimeve paraprake. Kur marrëveshja paraqitet në seancën paraprake, gjykata vendos sipas parashikimeve të paragrafit 4, të nenit 332/c, të këtij Kodi. Gjykata e shqyrton kërkesën në seancë gjyqësore brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e saj. Seanca zhvillohet me praninë e detyrueshme të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Viktima njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë. Mosparaqitja e viktimës nuk pengon shqyrtimin e çështjes. Pas verifikimit të paraqitjes së palëve, gjykata e deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe fton prokurorin për të paraqitur, në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e marrëveshjes së arritur. Mbrojtësi e merr fjalën, nëse e kërkon. Gjykata e pyet posaçërisht të pandehurin lidhur me sa më poshtë:⁷⁴

⁷⁴ Jahaj Dritan, Abdiu Rezarta, Qordja Nertila, Ajdari Fatbardha.... – Udhëzuesi mbi Kodin e Procedurës Penale për avokatët dhe asistent avokatët, Shkup,2019, f.27

- a) nëse e ka bërë marrëveshjen me vullnetin e tij të lirë;
- b) nëse ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtësi në bisedimet dhe nënshkrimin;
- c) nëse e kupton marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj;
- ç) nëse i ka kuptuar pasojat që vijnë prej miratimit të marrëveshjes;
- d) nëse jep pëlqimin që marrëveshja të miratohet dhe të vihet në ekzekutim.

2.2.1 Pranimi i marrëveshjes

Procedura në lidhje me miratimin e marrëveshjes nga ana e gjykatës, rregullohet në nenin 406/e të K.Pr.P. Sipas këtij neni, në rastet kur gjykata nuk vendos pushimin e çështjes ose kthimin e akteve prokurorit, ajo vendos miratimin e marrëveshjes me vendim. Ky vendim përmban të dhëna të përgjithshme për të pandehurin, të dhëna personale të tij dhe të viktimës së veprës penale në fjalë (nëse ka),) faktin që i pandehuri ka qenë i përfaqësuar dhe identitetin e mbrojtësit të tij; faktin që i pandehuri e ka kuptuar përmbajtjen e marrëveshjes dhe pasojat që vijnë prej saj dhe ka nënshkruar me vullnet të lirë; faktin se cilësimi juridik i veprës dhe rrethanat e saj, përshtatshmëria e dënimit të caktuar, si dhe mungesa e shkaqeve të padënueshmërisë apo të shuarjes së veprës penale, janë vlerësuar drejt nga prokurori; deklarinim fajtor të të pandehurit, caktimin e dënimit dhe disponime të tjera, sipas përmbajtjes së marrëveshjes dhe datën, nënshkrimin e vendimit.⁷⁵

2.2.2 Refuzimi i marrëveshjes

Në bazë të nenit 406/ë K.Pr.P , gjykata vendos të refuzojë marrëveshjen në këto raste: i pandehuri tërheq pëlqimin; provohet se vullneti i të pandehurit ka qenë i vesuar; i pandehuri i thirrur rregullisht nuk merr pjesë në gjyq, pa shkaqe të përligjura; ekziston një nga shkaqet e mosfillimit të procedimit ose të pushimit të akuzës ose çështjes; provat në fashikullin e hetimeve

⁷⁵ Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë, neni 406/e

vijnë në kundërshtim me pohimin e të pandehurit se ai e ka kryer veprën penale; cilësimi juridik i veprës penale dhe i rrethanave të kryerjes së saj është i gabuar; dënimi i caktuar në marrëveshje është i papërshtatshëm, në raport me veprën e kryer dhe personalitetin e të pandehurit.

2.3 Ngjashmëritë dhe dallimet me RMV-në

Nga e gjithë ajo që u tha më lartë, mund të vij në konkludim se të dy legjislacionet në përgjithësi janë të ngjashëm sa i përket çështjeve kryesore procedurale që kanë të bëjnë me kohën kur mund të parashtrahet propozimarrëveshja, kush janë subjektet e saj, përfaqësimin e të pandehurit nga ana e mbrojtësit etj.

Dallimi kryesor që e kam vërejtur, ka të bëjë me veprat penale për të cilat personi i dyshuar mund të gjykohet me marrëveshje. Përderisa në RMV ligjdhënësi nuk ka vendosur kufizime sa i përket faktit se për cilat vepra penale mund të parashtrahet propozimarrëveshje për pranimin e fajësisë, në Shqipëri ligjdhënësi ka përcaktuar së gjykimi me marrëveshje mund të bëhet vetëm në rastet kur personi i dyshuar ka kryer vepër penale e cila dënohet me dënim më burgim maksimum deri në 7 vjet dhe jo më shumë.

KAPITULLI IV

STUDIMI EMPIRIK - PASQYRA E TË DHËNAVE STATISTIKORE

1. SHEMBUJ DHE ANALIZË E AKTGJYKIMEVE TË SJELLA NË BAZË TË MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJËSISË NË GJYKATËN THEMELORE NË GOSTIVAR

Në këtë pjesë të punimit do të paraqes shembuj të aktgjykimeve të sjella në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në Gjykatën Themelore Gostivar. Qëllimi kryesor i vendosjes së këtyre shembujve të aktgjykimeve është që së pari të paraqes se si duket një aktgjykim i sjellë në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajit dhe njëkohësisht t'i kushtoj vëmendje çështjes se për cilat vepra penale janë sjellë këto aktgjykime, çfarë dënime u janë shqiptuar kryerësve të atyre veprave penale dhe sa janë të përshtatshëm ato dënime për arritjen e qëllimit të sanksionimit të kryerësve.

1.1 Aktgjykimi K-ΠΠ-50/18

Aktgjykimi në fjalë është sjellë në vitin 2018 në Gjykatën Themelore Gostivar në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Ky aktgjykim është sjellë nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, i cili e ka pranuar propozimmarrëveshjen e parashtruar.

Më konkretisht në këtë aktgjykim kemi një të akuzuar për vepër penale VJEDHJE e cila parashihet në nenin 235 të Kodit Penal, të cilën vepër penale e akuzuara shtetase e Serbisë e ka kryer në RMV, në dy shtëpi të ndryshme prej të cilave ka vjedhur sende të luajtshme me vlerë të konsiderueshme. Pas kësaj ajo është marrë në paraburgim me qëllim të sigurohet prezenca e saj, dhe gjatë kohës që ajo ka qenë në paraburgim ka lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë duke qenë e përfaqësuar nga avokati i saj nga Gostivari. Sipas propozimmarrëveshjes të lidhur në mes

PTHP Gostivar, të akuzuarës dhe mbrojtësit të saj, rrjedh se e akuzuara e ka pranuar se e ka kryer veprën penale dhe me këtë kërkojnë nga gjykata që ti shqiptojë masën alternative Dënim me kusht- dënim me burgim në kohëzgjatje prej një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afat prej dy viteve nuk kryen vepër të re penale.

Kjo propozimmarrëveshje, pas seancës për vlerësim të saj pranohet nga ana e gjyqtarit të procedurës paprapake dhe të akuzuarës i shqiptohet dënimi i propozuar dhe poashtu i shfuqizohet paraburgimi, me atë që obligohet të paguajë shpenzime të caktuara gjyqësore.

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE NË GOSTIVAR përmes gjyqtarit të procedurës paraprake E.A, me procesverbalistin M.K në lëndën penale të ngritur kundër të pandehurës K.Z nga R. e Serbisë, rr. A, pa nr, për arsye se ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer vepër penale “VJEDHJE” nga neni 235 parag. 1 në lidhje me parag.45 nga KP, duke vepruar sipas propozimmarrëveshjes të PTHP në Gostivar, të pandehurës Z.T dhe mbrojtësit të saj F.F, e lidhur në PTHP Gostivar, më datë 13.04.2018 në bazë të nenit 490 të LPP, sjell këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura K. Z me nr amzë 2689..... ngae punësuar, e martuar.....me vendbanim...

Ë S H T Ë F A J T O R E

SEPSE:

E pandehura në muajin Nëntor 2017, në fshatin N... në shtëpinë e V.D gjatë kohës që ishte mysafire në shtëpinë e V.D duke e shfrytëzuar pakujdesinë e saj ka hyrë në dhomën e gjumit nga ku ka marrë një kuti të vogël ku kishte stoli ari, të njejtat i ka përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme dhe pa e vërejtur askush është larguar, duke shkaktuar kështu dëm material në vlerë 420.000,00 denarë.

Në të njëjtën mënyrë, duke qenë mysafire në shtëpinë e A.D nga një sirtar ka marrë një varëse të arit dhe katër unaza poashtu të arit, të cilat i ka fshehur në një kuti plastike për cigare dhe i ka futur në çantën e saj.

Me veprimet e lartpërmendura e pandehura K.Z ka kryer vepër penale VJEDHJE nga neni 235 parag. 1 në lidhje me parag.45 nga KP, prandaj në pajtim me këtë nen dhe nenet 3,4,7,32,33,34,35,39,40,41 nga KP dhe neni 490 nga LPP, gjykata të pandehurës K.Z

I C A K T O N

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, kurse në pajtim me nenin 48,48-a, 49 dhe 50 të KP, gjykata I SHQIPTON

MASËN ALTERNATIVE

DËNIM ME KUSHT

Në mënyrë që dënimi i caktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 viti nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura në afat prej 2 viteve nuk kryen vepër të re penale.

.....

OBLIGOHET e pandehura të paguajë shpenzime 3.000,00 denarë pas pranimit të aktgjykimit.

II.

V E N D I M

Në pajtim me nenin 173 parag.5 të LPP-së paraburgimi i caktuar ndaj të pandehurës K.Z me nr amzë, nga nëna dhe babai, shtetase e R.S, me vendim të gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën themelore Gostivar KPP.nr 48/18 nga 10.04.2018 **SHFUQIZOHET** dhe e akuzuara menjëherë lëshohet në liri, kurse koha e kaluar në paraburgim do ti llogaritet në dënim.

Arsy etimi

Më datë 12.04.2018 në PTHP në Gostivar , e akuzuara K.Z, shtetase e R.Serbisë dhe mbrojtësi i saj F.F, avokat nga Gostivari lidhën marrëveshje për pranim të fajësisë KO.nr. 156/18 më datë 12.04.2018.

Gjyqtari i procedurës paraprake pas seancës së mbajtur për vlerësim të propozimmarrëveshjes vërtetoi se e e njejtja i përmban elementetet e parapara në nenin 485 të LPP-së.

Sipas propozimmarrëveshjes propozohet që gjyqtari i procedurës paraprake ta shpallë fajtore të akuzuarën K.Z për vepër penale VJEDHJE nga n.235 p.1 në lidhje me nenin 45 nga KP dhe ti caktojë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet përderisa e akuzuara në afat prej dy vitesh nuk kryen vepër të re penale.

.....

Në rastin konkret gjyqtari i procedurës paraprake e pranoi propozimmarrëveshjen e lidhur ndërmjet PTHP Gostivar, të akuzuarës K.Z dhe mbrojtësit të saj F.F, dhe të akuzuarës i shqiptoi masën alternative Dënim me kusht - dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet përderisa e akuzuara në afat prej dy vitesh nuk kryen vepër të re penale.

GJYQTARI I PROCEDURËS PARAPRAKE E.A

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi nuk lejohet ankesa.

1.2 Aktgjykimi КПП.6poj 62/19

Në këtë aktgjykim, personi i pandehur ka kryer vepër penale “SHKAKTIM I RREZIKUT TË PËRGJITHSHËM” e cila vepër parashihet në nenin 288 të Kodit Penal, paragrafi 3, në lidhje me parag.1 ku thuhet: “Ai i cili me zjarr, eksploziv, helm ose me veprim apo mjet tjetër të

rrezikshëm do të shkaktojë rrezikim të dukshëm të jetës dhe trupit të njerëzve do të dënohet me dënim me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet”. “... Nëse vepra kryet në vende ku janë të mbledhur një numër më i madh i personave, kryerësi do të dënohet me dënim me burg prej një deri pesë vjet”, për të cilën veprë është dënuar me kusht. Sipas mendimit tim, masa alternative dënimi me kusht i është shqiptuar për shkak se ka lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë, veprim ky me të cilin nënkuptohet se e ka pranuar fajin, përkundrazi me siguri do të dënohej me dënim me burg efektiv.

Fakti që vepra penale është kryer në vitin 2015, kurse propozimmarrëveshja është parashtruar në vitin 2019, dhe si rrjedhojë edhe aktgjykimi është sjellë poashtu në 2019 flet për iniciativën e munguar dhe të vonuar, si nga ana e prokurorisë ashtu edhe nga pala tjetër për zgjidhjen e çështjes penale në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajit, në bazë të së cilës mundësohet zgjidhje efektive dhe ekonomizim i procedurës penale.

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE NË GOSTIVAR përmes gjyqtarit të procedurës paraprake E.A, me procesverbalistin V.J në lëndën penale të ngritur kundër të pandehurit Q.A nga Gostivari, rr. A, pa nr, për arsye se ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprë penale “SHKAKTIM TË RREZIKUT TË PËRGJITHSHËM” nga neni 288 parag. 3 në lidhje me parag.1 nga KP, duke vepruar sipas propozimmarrëveshjes të PTHP në Gostivar, të pandehurit Q.A dhe mbrojtësit të tij Z.T, e lidhur në PTHP Gostivar, më datë 27.03.2019 në bazë të nenit 490 të LPP, sjell këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Q.A me nr amzë 154..... nga i lindur më, me vendbanim në

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Më datë 27.07.2015 rreth orës 16.00 në Gostivar me veprim dhe mjet të rrezikshëm – pistoletë, ka shkakuar rrezikim të dukshëm për jetën dhe trupin në vendin ku ishin mbledhur numër i madh

i njerëzve, në atë mënyrë që me pistoletë të tipit TANFOGLIO ka.9 mm Raga me numër serie AC04730 të cilin e posedonte me leje 056231 ka gjuajtur në ajër disa predha në rr.F... nr 2 në Gostivar, në oborrin e shtëpisë në pronësi të M.M ku mbahej manifestim familjar, ku e ka vendosur në rrezik jetën dhe trupin e një numri të madh të personave të pranishëm.

Me veprimet e lartëpërmendura i pandehuri Q.A ka kryer vepër penale Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm nga neni 288 parag. 3 në lidhje me parag.1 nga KP, kështuqë në pajtim me nenin 490 të LPP, gjykata të pandehurit Q.A

I C A K T O N

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, kurse në pajtim me nenin 48,48-a, 49 dhe 50 të KP, gjykata të pandehurit Q.A **I SHQIPTON**

MASËN ALTERNATIVE

DËNIM ME KUSHT

Në mënyrë që dënimi i caktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 vitesh nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 5 viteve nuk kryen vepër të re penale.

.....

OBLIGOHET i pandehuri të paguajë shpenzime 5.000,00 denarë në afat prej 15 ditësh.

A R S Y E T I M I

Më datë 27.03.2019 prokurori publik A.A nga PTHP Gotivar, I pandehuri Q.A nga Gostivari dhe mbrojtësi i tij Z.T nga Gostivari kanë lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i procedurës paraprake në senacën e mbajtur për vlerësimin e propozimmarrëveshjes vërtetoi se e njëjta i përmban elementet e parapara në LPP.

Në propozimmarrëveshjen, propozohet që gjyqtari I procedurës paraprake ta shpallë fajtor të pandehurin Q.A për veprën penale Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, ti caktojë dënim me burgim prej 2 vitesh, e cila nuk do të ekzekutohet përderisa i pandehuri në afat prej 5 vitesh nuk kryen vepër të re penale.

.....

Sipas të lartëpërmendurave u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYQTARI I PROCEDURËS PARAPRAKE E.A

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi nuk lejohet ankesa.

1.3 Aktgjykimi K-ΠΠ-8/19

Ky aktgjykim është sjellë poashtu në Gjykatën Themelore në Gostivar, në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Personi i akuzuar, shtetas i huaj, i cili është person i ri në moshë, ka kryer veprën penale Prodhim i pa lejuar dhe lëshim në qarkullim të substancave narkotike, psikotrope dhe prekursorëve, e cila parashihet në nenin 215 të Kodit Penal.

Gjatë një kontrole policore natën e ndërrimit te viteve, në një nga klubet e qytetit të Gostivarit, të akuzuarit në fjalë policia i kanë gjetur dy paketime me Kokainë, të cilat I kishtë përgaditur për shitje dhe të njejtat i janë marrë. Pas kësaj, më datë 09.01.2019, PTHP Gostivar dhe i akuzuari së bashku me mbrojtësin e tij në PTHP Gostivar kanë lidhur marrëveshje për pranim të fajësisë, sipas të cilës I kërkojnë gjyqtarit të procedurës paraprake që të akuzuarin ta shpallë fajtor për veprën penale në fjalë, duke i shqiptuar kështu dënim me burgim në kohëzgjatje prej një viti, I cili nuk do të ekzekutohet derisa i akuzuari në afat prej dy viteve nuk kryen vepër tjetër penale. Përveç kësaj me propozimmarrëveshje i është propozuar gjykatës që të akuzuarit ti shqiptojë edhe dënimin Përzënia e të huajit nga RMV në kohëzgjatje prej një viti dhe sipas nenit 215 p.7 të KP substanca narkotike ti merret.

Gjykata pas vlerësimit të propozimmarrëveshjes, do ta pranojë të njejtën dhe sjell këtë aktgjykim:

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

GJYKATA THEMELORE NË GOSTIVAR përmes gjyqtarit të procedurës paraprake E.A, me procesverbalistin S.S në lëndën penale të ngritur kundër të pandehurit B.S, për arsye se ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprën penale Prodhim i pa lejuar dhe lëshim në qarkullim të substancave narkotike, psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215 parag. 2 në lidhje me parag. 1

të KP, dhe duke vepruar sipas propozimarrëveshjes së PTHP Gostivar, të akuzuarit B.S dhe mbrojtësit të tij F.M të lidhur në PTHP Gostivar me nr. KO 1/19 më datë 09.01.2019shpall këtë

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. S nga babai..... dhe nëna i lindur më.....me vendbanim në.....

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Më datë 01.01.2019 rreth orës 01.00 në Gostivar në klubin “AA”, në mënyrë të paautorizuar ka blerë për shitje drogë narkotike Kokainë në dy paketime me masë neto 0,22 gram dhe 0,17 gram ose gjithësejt në të dy paketimet 0.39 gram Kokainë, si dhe një qese polietileni e hapur me mbetje të Kokainës, të cilat i janë gjetur në xhepin e majtë nga ana e punonjësve të policisë dhe të njejtat janë marrë.

Me veprimet e lartpërmendura i akuzuari B.S, shtetas i R. së Austrisë ka kryer vepër penale Prodhim i pa lejuar dhe lëshim në qarkullim të substancave narkotike, psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215 parag. 2 në lidhje me parag. 1 të KP, prandaj në pajtim me nenin 490 të LPP, gjykata të akuzuarit B.S

I C A K T O N

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, kurse në pajtim me nenin 48,48-a, 49 dhe 50 të KP, gjykata të pandehurit B.S **I SHQIPTON**

MASËN ALTERNATIVE

DËNIM ME KUSHT

Në mënyrë që dënimi i caktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 viti nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 viteve nuk kryen vepër të re penale dhe I shqipton

dënim Përzënia e të huajit na RMV në kohëzgjatje prej 1 viti sipas nenit 38-g nga KP. Në bazë të nenin 215 p.7 të KP substanca narkotike i merret në shfrytëzim të RMV-së.

OBLIGOHET i pandehuri të paguajë shpenzime 5.000,00 denarë në afat prej 15 ditësh.

ARSYETIMI

Më datë 09.01.2019 në PTHP Gostivar, i akuzuari B.S dhe mbrojtësi i tij F.M avokat nga Gostivari, lidhën marrëveshje për pranim të fajësisë KO. nr. 1/19 nga 09.01.2019.

Gjyqtari i procedurës paraprake në senacën e mbajtur për vlerësimin e propozimarrëveshjes vërtetoi se e njëjta i përmban elementet e parapara në LPP.

Më propozimarrëveshjen i kërkohet gjyqtarit të procedurës paraprake që të akuzuarin B.S ta shpallë fajtor për veprën në fjalë dhe ti shqiptojë dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 viteve nuk kryen vepër të re penale dhe ti shqipton dënim Përzënia e të huajit na RMV në kohëzgjatje prej 1 viti sipas nenit 38-g nga KP. Në bazë të nenin 215 p.7 të KP substanca narkotike ti merret në shfrytëzim të RMV-së.

.....

Në rastin konkret gjyqtari i procedurës paraprake e pranoi propozimarrëveshjen dhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYQTARI I PROCEDURËS PARAPRAKE E.A

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi nuk lejohet ankesa.

2. PASQYRË STATISTIKORE PËR TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE GOSTIVAR DHE TË DHËNA STATISTIKORE PËR PUNËN E PROKURORIVE PUBLIKE NË RMV LIDHUR ME MARRËVESHJET PËR PRANIMIN E FAJËSISË

Me qëllim të pasurimit të punimit me të dhëna konkrete statistikore në lidhje me zbatimin në praktikë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në prokuroritë themelore në RMV si një institut i ri, kam analizuar të dhëna statistikore nga Enti shtetëror për statistikë, që kanë të bëjnë me numrin e përgjithshëm të marrëveshjeve të lidhura, fazën e procedurës kur janë lidhur këto marrëveshje, dënimet që janë propozuar dhe janë shqiptuar ndaj kryerësve në përgjithësi në RMV, për tu ndalur më pas konkretisht në disa raste nga PPTH Gostivar.

Sipas të dhënave statistikore të grumbulluara nga Raportet vjetore për punën e Prokurorive Publike në RMV, prej vitit 2014 deri në vitin 2018 janë lidhur gjithësejt 1918 marrëveshje për pranimin e fajësisë për vepra të ndryshme penale, duke filluar nga ato me rrezikshmëri të ulët shoqërore e deri te veprat më të rënda penale.

Tabela 1. Marrëveshjet e lidhura sipas vitit në PP të RMV-së

| Viti | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|------------------------|------|------|------|------|------|
| Marrëveshje të lidhura | 284 | 300 | 458 | 327 | 280 |

Nga ajo që shihet në këtë tabelë, për fat të keq ky institut i ri ende nuk është jetësuar dhe nuk është vënë në zbatim sa duhet. Në vitin 2014, i cili është viti kur edhe ka filluar të zbatohet marrëveshja për pranimin e fajësisë janë lidhur vetëm 284 marrëveshje, që do të thotë se vetëm

0,68% e rasteve të përgjithshme janë zgjidhur me anë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Në territorin e Gjykatës Themelore Gostivar, apo në territorin e Prokurorisë së Lartë Publike Gostivar në vitin 2014 ka pasur vetëm një marrëveshje, me të cilën personi i akuzuar për vepër penale që dënohet deri pesë vite burg, ka marrë Dënim me kusht.

Në vitin 2015 ka një rritje të vogël të numrit të marrëveshjeve të lidhura - 1,3%, kurse 2% e propozimmarrëveshjeve kanë qenë në Prokurorinë e Lartë Publike në Gostivar. Viti i ardhshëm poashtu shënon rritje të numrit të marrëveshjeve edhe atë me 458 raste (numri më i madh i marrëveshjeve) të zgjidhura me marrëveshje për pranimin e fajësisë, 4,5% e të cilave në territorin e Prokurorisë së Lartë Publike në Gostivar. Dy vitet në vazhdim shihet një ulje e numrit të marrëveshjeve, edhe atë 2017 vetëm 327 raste dhe 2018 vetëm 280 raste, 0,7% e të cilave janë zgjidhur në procedurë sumare.

Në tabelat në vazhdim do të paraqes numrin e marrëveshjeve të lidhura dhe kohën e lidhjes së tyre në territorin e Prokurorisë së Lartë Publike në Gostivar dhe Shkup për vitet 2016,2017 dhe 2018.

Tabela 2. Numri i marrëveshjeve të lidhura në 2016 dhe koha e lidhjes së tyre

| | Procedurë sumare | Procedurë hetuese | Pas ngritjes së aktakuzës | Gjithësejt | % |
|---------------------|------------------|-------------------|---------------------------|------------|------|
| PPL Gostivar | 1 | 20 | / | 21 | 4.5 |
| PPL Shkup | 136 | 99 | 7 | 242 | 52.8 |

Nga të dhënat mund të konstatojmë se numri më i madh i marrëveshjeve për vitin 2016 janë lidhur në territorin e PPL Shkup, edhe atë 52.8 % e marrëveshjeve, kurse në PPL në Gostivar kemi një numër të vogël të marrëveshjeve të lidhura.

Tabela 3. Numri i marrëveshjeve të lidhura në 2017 dhe koha e lidhjes së tyre

| | Procedurë sumare | Procedurë hetuese | Pas ngritjes së aktakuzës | Gjithësejt | % |
|---------------------|------------------|-------------------|---------------------------|------------|----|
| PPL Gostivar | 15 | 22 | / | 37 | 11 |
| PPL Shkup | 86 | 96 | 4 | 186 | 57 |

Këto të dhëna statistikore janë tregues se numri i marrëveshjeve për pranimin e fajësisë nga viti në vit shkon duke u rritur, që kjo që ndikon pozitivisht në punën e gjykatave dhe zgjidhjen sa më të shpejtë të çështjeve penale.

Tabela 4. Numri i marrëveshjeve të lidhura në 2018 dhe koha e lidhjes së tyre

| | Procedurë sumare | Procedurë hetuese | Pas ngritjes së aktakuzës | Gjithësejt | % |
|---------------------|------------------|-------------------|---------------------------|------------|----|
| PPL Gostivar | 13 | 20 | 2 | 35 | 13 |
| PPL Shkup | 82 | 51 | 3 | 136 | 49 |

Nga këto të dhëna shihet se në vitin 2018 numri më i madh i marrëveshjeve të lidhura është në territorin e PPL në Shkup edhe atë me 49%.

3. ZBATIMI NË PRAKTIKË I MARRËVESHJES PËR PRANIMIN E FAJËSISË

Në këtë pjesë të punimit janë paraqitur të dhëna dhe njohuri të cilat i kam marrë gjatë realizimit të intervistës me gjykatësen e procedurës paraprake në Gjykatën Themelore Shkupi 1, znj. Vesna Dimishkova. Ajo gjatë intervistës edhe pse e realizuar përmes telefonit për shkak të situatës së rë të krijuar ishte e gatshme për të ofruar të gjitha njohuritë dhe të dhënat nga praktika sa i përket zbatimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë si institut i ri në procedurën tonë penale.

Kur jemi te zbatimi në praktikë i këtij institucioni vlen të përmendet se ka gjetur zbatim në praktikën gjyqësore të RMV-së, por pasi është institut i ri ende nuk është jetësuar shumë në praktikë. Zbatimi në praktikë i marrëveshjeve për pranimin e fajësisë varet nga shumë faktorë, por më e rëndësishme është të theksohet roli i prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit. Ashtu siç e kam thënë edhe më sipër, marrëveshjet për pranimin e fajësisë ende nuk zbatohen aq sa duhet në praktikë edhe pse do të duhej që të kishim shumë më shumë raste të zgjidhura në bazë të tyre, por fatkeqësisht si institut ende nuk është jetësuar.

Për tu lidhur një marrëveshje për pranimin e fajësisë, ligjdhënësi nuk na ka dhënë kufizime për sa u përket veprave penale, që do të thotë se marrëveshje për pranimin e fajësisë mund të lidhet për çdo vepër penale, por kjo varet shumë edhe nga mbrojtësi i të pandehurit pasi ai si përfaqësues i personit të pandehur duhet që atij t'ia tregojë gjendjen reale. Nëse avokati realisht ia tregon gjendjen të akuzuarit duke i thënë se ka dëshmi të forta kundër tij dhe nuk ka shumë mundësi që të mbrohet pasi që prokurori disponon numër të madh të provave dhe i propozon atij që të pranojë veprën e kryer dhe të lidhin marrëveshje me prokurorin, në mënyrë që ai të merr dënim më të vogël, atëherë do të kishte zbatim më të madh të këtij instituti, në të kundërt nëse avokati e "gënjen" të akuzuarin duke i thënë që nuk ka fakte dhe prova që ai është fajtor, atëherë do të shkojnë në gjykim. Gjithashtu zbatimi në praktikë varet edhe nga fakti se sa prokurorët publikë dëshirojnë që çështjet penale ti zgjidhin me marrëveshje, apo ato preferojnë mënyrën e rregullt.

Nga kjo që u tha më lartë, teoritikisht del se iniciativën për të lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë mund ta marrë prokurori publik, avokati apo personi i dyshuar, por si është në të vërtetë në praktikë? Më së shpeshti në praktikë, nëse lënda është ende në gjykatë që të vendoset për paraburgimin, vetë prokurori publik mund të ndërmerr iniciativën, por përsëri nuk mund të themi se kjo apo ajo palë e ndërmerr iniciativën, pasi që kjo varet shumë edhe nga vetë rasti. Ka raste kur prokurori publik nuk pranon në asnjë mënyrë që të lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë, por kërkon që të shkohet në gjykim, megjithatë mund të thuhet se deri diku është përqindja e njejtë sa i përket faktit se cila palë e inicon lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, por përsëri duhet të them se rolin më të rëndësishëm e kanë prokurori dhe avokati i të akuzuarit, pasi që i akuzuari nuk e njeh të themi ligjin dhe i beson shumë përfaqësuesit të tij, i cili nëse i tregon se si janë gjasat dhe e këshillon që të lidhin marrëveshje atëherë i akuzuari do të lidhë marrëveshje.

Duke u parë nga këndvështrimi i atyre që në praktikë marrin me zbatimin e këtij instituti, marrëveshja për pranimin e fajësisë është shumë e rëndësishme dhe u ndihmon shumë atyre, sepse e shkurton dhe e përshpejton procedurën penale dhe poashtu i zvogëlon shpenzimet e procedurës. Pasi që çdo lëndë përfundon me aktgjykim edhe në rastet e marrëveshjeve për pranim të fajësisë sillet aktgjykim, por dallimi qëndron në faktin se ky aktgjykim sillet në procedurë paraprake, kështu që nuk ka aktakuzë, nuk ka gjykim, nuk do të ketë ankesa dhe gjykim në shkallë të dytë, e as mjete të jashtëzakonshme. Me anë të këtij instituti arrihet rezultati i njejtë, por shumë më shpejt dhe në mënyrë më efikase. *“Kjo është e njejtë sikur të nisemi prej Shkupit për në Tetovë direkt për në Tetovë, dhe jo prej Shkupit nëpërmjet Velesit, Gjevgjelisë, Ohrit, Gostivarit dhe të arrijmë në Tetovë. Në të dy rastet rezultati është i njejtë, por rruga nëpër të cilën kalon nëse nuk lidhet marrëveshje është më e gjatë, më e shtrenjtë dhe ka mundësi që të shqiptohet edhe dënim më i lartë në krahasim me dënimin që ka mundur të shqiptohet me anë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.”⁷⁶*

⁷⁶ Të dhëna nga intervista e realizuar me gjyqtaren e procedurës paraprake në Gjykatën Penale Shkupi 1 - Vesna Dimishkova, 28.04.2020

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Marrëveshja për pranimin e fajësisë në praktikën gjyqësore në shumë shtete në të cilat zbatohet si institut proceduralo-penal ka pasur sukses në arritjen e qëllimit të drejtësisë penale, që është zbulimi dhe dënimi i kryerësve të veprave penale.

Në RMV, në LPP ky institut është inkorporuar relativisht vonë dhe ndoshta kjo është arsyeja se pse nuk ka gjetur ende zbatim sa duhet në shumicën e gjykatave, dhe si pasojë e kësaj nuk kemi numër të madh të çështjeve penale të zgjidhura në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Për këtë arsye e kam parë të nevojshme hulumtimin dhe shkrimin e një punimi shkencor në lidhje me këtë temë, që sadopak të ndikojë në promovimin e këtij instituti për mendimin tim shumë të rëndësishëm në procedurën penale. Shikuar kah aspekti i ndikimit pozitiv të tij në procedurën penale, mund të përmendi përparësitë e zgjidhjes së çështjeve penale me anë të marrëveshjes për pranimin e fajit, si për shembull: efikasiteti i procedurës, zvogëlimi apo ekonomizimi i shpenzimeve të procedurës, ndërsa sa i përket benefiteve që i fiton i dyshuari në bazë të marrëveshjes ato janë: mundësia për dënim më të lehtë, shkurtimi i procedurës, përmirësimi i pozitës së tij si i dënuar etj.

Në bazë të statistikave dhe të dhënave që janë përfshirë në këtë hulumtim, mund të konkludoj se për fat të keq ky institut zbatohet shumë pak në vendin tonë, me theks të veçantë mund të përmendi zbatimin e tij në territorin e Gjykatës Themelore Gostivar, ku prej hulumtimit të të dhënave dhe bisedës me gjyqtarin e procedurës paraprake në Gjykatën Themelore Gostivar rezulton se prej vitit 2014 deri në vitin 2018 vetëm pesë çështje penale janë zgjidhur në bazë të marrëveshjes së prokurorit publik dhe të dyshuarit.

Rekomandimi im nga ky punim është që të vendoset një mekanizëm juridik i cili do të mundësonte zbatim më të gjerë të këtij instituti. Poashtu rekomandoj që të mbahen më shumë trajnime profesionale për prokurorët dhe avokatët, ku ato të nxiten që sa më shumë çështje penale ti zgjidhin përmes marrëveshjeve për pranimin e fajësisë. Rekomandimi im i fundit, por jo edhe për nga rëndësia është që personave të akuzuar tu mundësohet që të kenë sa më shumë

njohuri mbi këtë institut dhe benefitet që u sjell zbatimi i tij, përmes reklamave dhe programeve të ndryshme apo nga avokatët e tyre.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Libra:

- Boari, Nikola and Gianluca Fiorentini, An Economic Analysis of Plea Bargaining: the Incentives of the Parties in the Mixed Penal System, International Review of Law and Economics, Vol. 21. Issue 2, June, 2001, p.p. 213-231, copyright: Elsevier Science Inc.
- Bohlander, Michael, Plea Bargaining-Waiver of Right to Appeal, The Journal of Criminal Law, 2005
- Buckle, Suzann R Thomas, Buckle Leonard G., Bargaining for justice: case disposition and reform in the criminal courts, London; New York: Praeger, 1977
- D'Andrea, Alesandro, Shortened procedures, Collection of texts, Twinning Project Fight Against Organized Crime and Corruption Unit – Public Prosecutor's Office, Skopje, 2009
- Doracak për procedurën penale: për avokatët / Vjosa Shkodra, Yll Zekaj]. - [Shkup]: [Dhomës Amerikane të avokatisë], 2019.
- Fisher George, Plea bargaining's triumph: a history of plea bargaining in America, Stanford University Press, 2003
- Kambovski Vlado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2010
- Rosett Arthu , Donald R. Cressey, Justice by consent: plea bargains in the American courthouse, Philadelphia: Lippincott, c 1976
- Sahiti Ejup, Murati Rexhep, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013
- Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2018
- Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Tetovë, 2007
- Zejneli Ismail, Kambovski Vlado, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018
- Бужаровска Гордана, Спогудување на вина: Прирачник за практичари (Гордана Бужаровска, Мајкл Г. Карнакас, Дејвид Пе) - Скопје: ОБСЕ, 2010
- Матовски, Никола, Казнено процесно право-општ дел, Скопје 2003
- Проф. д-р Лазетиќ Бужаровска Гордана, проф. Калајџиев Гордан, доцент д-р Илиќ Димовски Дивна, Казнено процесно право, Скопје 2015
- Фридрих-Кристијан Шредер, Казнено процесно право, Скопје, 2010

Artikuj shkencor:

- Besa Arifi. Независноста на судството како основно начело на правната држава - Independence of Judiciary as the fundamental principle of rule of law. In Независност на судството - научна и стручна расправа одржана на 3 ноември 2015 година во Скопје, Македонска Академија на Науките и Уметностите, книга 7, pp. 137-154. Macedonian Academy of Sciences and Arts, Skopje, 2015.
- Besa Arifi. Правилник за начинот на одмерување на казните - pro et contra (The Rule on Sentencing Guidelines – Pro et Contra). In Macedonian Journal of Criminal Law and Criminology, pp. 185-198. Macedonian Association for Criminal Law and Criminology, Skopje, 2014. ISBN 1409-5327.
- Dritan Jahaj, Rezarta Abdiu, Nertila Qordja, Fatbardha Ajdari – Udhëzuesi mbi Kodin e Procedurës Penale për avokatët dhe asistent avokatet, Shkup, 2019
- Edina Jupolli, JUSTICIA - Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar Viti VI, Nr 6/2016-2018, Prishtinë, 2018
- Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, Komentar Kodi i Procedurës Penale i RKS
- Emilio C. Viano, Plea Bargaining in the United States: A Perversion of Justice, Revue internationale de droit pénal 2012/1 (Vol. 83), p. 109-145. DOI 10.3917/ridp.831.0109
- JUSTICIA Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar Viti VI, Nr 6/2016-2018
- Marko Zvrlevski, Todor Vitlarov, Jovan Ilievski, Zbatimi Praktik I Marrëveshjes Për Llojin Dhe Lartësinë E Sanksionit Penal Në Vitin E Parë Të Zbatimit Të Ligjit Të Ri Për Procedurë Penale, analiza juridike, Shkup 2016
- Plea and Charge Bargaining – Research Summary, Bureau of Justice Assistance, U.S Department of Justice
- Plea Bargaining's Triumph: A History of Plea Bargaining in America, George Fisher, 2004
- Practical Application of Plea Bargaining for the type and severity of criminal sanction in the 1st year of its application on the new law on criminal procedures, OSCE, 2016
- Ramiz Buzhala, Kujtim Krasniqi, MARËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË

- Udhëzues per Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, 2013
- Адвокат Љубомир Михајловски, Адвокат Бојана Неткова, Адвокат Елена Грижева ... и др - ПРИРАЧНИК ЗА КРИВИЧНА ПОСТАПКА, за адвокати, Скопје
- Гордан Калајџиев, Гордана Лажетиќ, Лидија Неделкова ... и др - КОМЕНТАР на Законот за кривична постапка - Скопје, ОБСЕ, 2018.
- Гордана Лажетиќ Бужаровска, Концептите за спогодување и признавањето вина во реформата на казнено-процесно законодавство, Втор Скопско-Загребски Колоквиум, Скопје-Загреб, ноември, 2008
- Камбовски Владо ,Актуелни проблеми на казнената политика, МР КПК, год. 12 бр. 1, 2005 година
- Марко Зврлевски, Тодор Витларов, Јован Илиевски - ПРАКТИЧНА ПРИМЕНА НА СПОГОДУВАЊЕТО ЗА ВИДОТ И ВИСИНАТА НА КРИВИЧНАТА САНКЦИЈА ВО ПРВАТА ГОДИНА ОД ПРИМЕНАТА НА НОВИОТ ЗАКОН ЗА КРИВИЧНА ПОСТАПКА, ПРАВНА АНАЛИЗА, Скопје, 2016
- Проф Гордана Бужаровска – Лажетиќ, проф. Лазар Нанев, проф. Олга Кошевалиска, Слободното судско уверување и индивидуализацијата на санкциите во светлината на законските решенија за воедначување на казнената политика
- Проф. Марко Зврлевски, проф. Тодор Витларов, проф. Јован Илиевски – Практична примена на спогодувањето за видот и висината на кривичната санкција во првата година од примената на новиот Закон за кривична постапка – Скопје, 2016

Ligje dhe konventa ndërkombëtare:

- Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
- Kodi I Procedurës Penale I Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Kosovës
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.199, 30.12.2014

- Ligji për procedurë penale 1997
- Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.150/2010
- Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.150/07
- Recommendation No. R (87) 18 concerning the simplification of criminal justice.

Linqe nga interneti:

- <http://www.pravo.org.mk/>
- <http://www.rolpik.org/aprovohet-marreveshja-mbi-pranimin-e-fajesise-pritet-shpallja-e-aktgjykimit/>
- <http://www.svedok.org.mk/mk/record.php?id=1070>
- <https://akademik.mk/>
- <https://connectusfund.org/15-serious-advantages-and-disadvantages-of-plea-bargaining> (accessed February 26, 2020)

-
- <https://jorm.gov.mk>
 - <https://shqiptarja.com/lajm/gjykimi-me-marrveshje-risia-qw-refuzojnw-gjyqtarwt>
 - <https://www.pravdiko.mk/samo-vinovni-litsa-se-spogoduvaat-so-obvinitelite/>
 - <https://www.pravdiko.mk/spogoduvan-e-za-vina-spored-noviot-zkp/>
 - [Jon'a F. Meyer](#), Plea bargaining, Encyclopædia Britannica, - Encyclopædia Britannica, inc., October 17, 2019 – retrieved from <https://www.britannica.com/topic/plea-bargaining> (accessed February 26, 2020)

-
- Oliver, Wesley MacNeil (2013) "Toward a Common Law of Plea Bargaining," Kentucky Law Journal: Vol. 102: Iss. 1, Article 4. Available at: <https://uknowledge.uky.edu/klj/vol102/iss1/4> (accessed February 28, 2020)